



UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE  
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА  
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY

**FAKULTET I BIZNESIT DHE EKONOMISË**

**TEZA E MASTERIT**

**ANALIZA E BONITETIT DHE KREDIBILITETIT GJATË MIRATIMIT  
TË MIKROKREDIVE**

---

**Kandidatja:**  
Blerina Muaremi

**Mentor:**  
Akademik Abdylmenaf Bexheti

## Korrik 2020

Drejt përmbushjes së kërkesës për procesimin e mëtutjeshëm të tezës së masterit, e përcaktuar nga rregullorja e ciklit të dytë të studimeve pranë Universitetit të Evropës Juglindore.

Unë, Blerina Muaremi, dorëzoj punën e bërë deri tani në temën: ***“Analiza e bonitetit dhe kredibilitetit gjatë miratimit të mikrokredive”***, nën udhëheqjen e Akademik Abdylmenaf Bexhetit, që përmbush kriteret e përcaktuara nga rregullorja e këtij cikli.

## Përmbajtja

|  |           |
|--|-----------|
| HYRJE DHE QËLLIMET E STUDIMIT.....   | 5         |
| <b>1.1 Hyrje .....</b>   | <b>5</b>  |
| <b>1.2 Qëllimet e hulumtimit .....</b>   | <b>5</b>  |
| <b>1.3 Hipotezat.....</b>  | <b>6</b>  |
| <b>1.4 Metodologjia e hulumtimit.....</b>  | <b>7</b>  |
| <b>1.5 Struktura e punimit.....</b>  | <b>8</b>  |
| KAPITULLI I: SEKTORI BANKAR NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË .....   | 10        |
| <b>2.1 Pse ekzistojnë bankat? Teoria e ndërmjetësimit financiar .....</b>  | <b>10</b> |
| <b>2.2 Përshkrimi i sektorit bankar në Republikën e Maqedonisë së Veriut .....</b>                               | <b>12</b> |
| <b>2.3 Vlerësimi i bonitetit të bankave, rejtingu i bankave dhe institucionet tjera<br/>    financiare .....</b> | <b>14</b> |
| <b>2.4 Depozitat dhe kreditë.....</b>  | <b>18</b> |
| KAPITULLI II: KREDITIMI , DEFINIMI , PROCESI DHE LLOJET , ME THEKS TË VEÇANT NË MIKROKREDITIM                    | 23        |
| <b>3.1 Procesi i kredisë .....</b>   | <b>23</b> |
| <b>3.2 Tipet e kredisë .....</b>   | <b>23</b> |
| <b>3.3 Politika e kredihënies dhe procedura .....</b>  | <b>29</b> |
| <b>3.4 Analiza kreditore .....</b>   | <b>33</b> |
| <b>3.5 Informatat kreditore .....</b>  | <b>34</b> |
| <b>3.6 Konfirmimi i zhvlerësimit dhe rezervës speciale .....</b>   | <b>41</b> |
| <b>3.7 Mikrokreditmi.....</b>  | <b>53</b> |
| 3.7.1 Origjina e krijimit të mikrokredive .....  | 54        |
| 3.7.2 Normat e interesit të mikrokreditimit .....  | 57        |
| KAPITULLI III: PROFILI I KURSIMORES MOZHNOSTI .....  | 59        |
| <b>4.1 Historiku .....</b>   | <b>59</b> |
| <b>4.2 Strategjia e perdorur dhe misioni.....</b>  | <b>60</b> |
| <b>4.3 Miratimi i kredive .....</b>  | <b>61</b> |
| <b>4.4 Mikrokreditimi te kursimorja „Mozhnosti” .....</b>  | <b>63</b> |
| <b>4.5 Vlerësimi i rrezikut të kredisë në kursimoren „Mozhnosti “ .....</b>                                      | <b>64</b> |
| <b>4.6 Kontrolli i kufijve të ekspozimit dhe politikave të mbrotjes së rrezikut .....</b>                        | <b>68</b> |
| <b>4.7 Garancitë për kreditë mikro dhe shumë klientë të vegjël .....</b>   | <b>69</b> |
| <b>3.8. Produktet kreditore.....</b>   | <b>72</b> |

|                                     |                                     |            |
|-------------------------------------|-------------------------------------|------------|
| <b>4.8</b>                          | <b>Risku nga interesi .....</b>     | <b>73</b>  |
| 4.8.1                               | Analiza Financiare .....            | 74         |
| KAPITULLI IV: METODOLOGJIA.....     |                                     | 78         |
| <b>5.1</b>                          | <b>Hulumtimi.....</b>               | <b>78</b>  |
| <b>5.2</b>                          | <b>Grumbullimi.....</b>             | <b>78</b>  |
| <b>5.3</b>                          | <b>Rrezultatet.....</b>             | <b>79</b>  |
| <b>5.4</b>                          | <b>Rezultatet nga anketimi.....</b> | <b>86</b>  |
| KONKLuzionet dhe Rekomandimet ..... |                                     | 105        |
| Literatura e shfrytëzuar.....       |                                     | 110        |
| <b>Shtojca .....</b>                |                                     | <b>114</b> |

## ABSTRAKT

Sistemit i kreditimit ka një rol të rëndësishëm në ruajtjen e stabilitetit të sistemit bankar jo vetëm në shtetet e zhvilluara por edhe në shtetet me një zhvillim të mëvonshëm. Si pjesë e rrjetit të sigurisë bankare, mbikëqyrja e bankave nga ana e Bankës Popullore luan një rol të veçantë në rritjen e besueshmërisë në banka, vendosjen e normave dhe ligjeve në kontekst të efikasitetit dhe efijencës së kreditimit në përputhje me standardet ndërkombëtare mbikëqyrëse. Paralelisht me vendosjen e përmirësimit të procesit të miratimit të kredive është më se e nevojshme mbikëqyrja dhe koordinimi i niveleve kreditore deri te zvogëlimi i kohës për përgatitjen e një analize.

Duke u bazuar në të dhënat zyrtare të publikuara nga Banka Popullore e Maqedonisë së Veriut për sistemin kreditor si dhe përgjigjet e siguruara nga të anketuarit , qëllimi i këtij punimi është të analizojë procesin e mikrokreditimit në vend me qëllim që të arrihet te analiza e bonitetit dhe kredibilitetit të mikrokredive.

Për të arritur qëllimin e këtij punimi shkencor janë përdorur metoda të ndryshme si: anketime me punonjës të institucioneve financiare, raporte zyrtare nga Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe të dhëna nga Enti statistikor i Republikës së Maqedonisë së Veriut.

***Fjalët kyçe: Procesi kreditor, analiza kreditore, mikrokreditet, sistemi kreditor dhe efikasiteti dhe efijenca e procesit të kreditimit.***

# HYRJE DHE QËLLIMET E STUDIMIT

## 1.1 Hyrje

Qëllimi bazë i punimit është të analizohet procesi i përcaktimit të bonitetit dhe kredibilitetit të mikrobizneseve në vend. Bankat janë institucione financiare më të rëndësishme të një ekonomie, pasi që ato janë burim kryesorë i kredive për individët, familjet si dhe institucionet dhe ndërmarrjet e ndryshme. Roli i temës që do të shtjellohet është paraqitja dhe përcaktimi i ndikimit të analizës kreditore dhe ndikimi i tyre në stabilitetin e sistemit bankar në Republikën e Maqedonisë së Veriut duke analizuar segmente të caktuara të këtij rrjeti.

## 1.2 Qëllimet e hulumtimit

Pra, rëndësia qëndron në ndikimin dhe efektet e rrjetit të sigurisë së institucioneve financiare që ka sistemi bankar në Maqedoninë e Veriut, me theks të veçantë rrjeti i kredidhënies. Objektivi kryesorë i punimit është të analizohet boniteti i kredidhënies të mikrokredive në përgjithësi, dhe në Maqedoninë e Veriut, kudo të ndalemi në analizën e disa bankave , me qëllim që të identifikojmë faktorët që ndikojnë në realizimin e dhënies së kredive.

Në këtë punim do të trajtojmë anën konceptuale dhe llojllojshmërinë e institucioneve financiare, me fokus në shërbimet që këto të fundit ofrojnë si dhe rolin që kanë në zhvillimin ekonomik të një vendi, si dhe determinantat që do të jenë objekt studimi në proces të kredi

dhënies, analizës së kredi dhënies, si dhe një analize të shkurte për kursimoren Mozhnosti. Fokusi i studimit do jetë tek studimi i mikrokredive, depozitat, norma e interesit, fitimi, shpejtësia e parasë, kursi i këmbimit, informacionit asimetrike, koleteral, fitimi si dhe ndikimi i tyre gjatë procesit të kredi dhënies. Për qëllimet e këtij hulumtimi do të përgatitet një pyetësor që do na ndihmojë drejt përgjigjes së hipotezave. Sa i përket grumbullimit të të dhënave, do të shfrytëzojmë të dhëna nga Banka Qendrore që do na ndihmojnë në këtë analize të disa variablave.

Kjo tezë mer këtë problem duke analizuar dhe vlerësuar se si mikro ndërmarrjet si dhe familjarët që janë të prekur nga pjesëmarrja në një program të mikrokreditit. Duke përdorur një metodë sasiore në performancat e biznesit. Si dhe rezultatet do të tregojnë se pjesëmarrja në një program të mikrokredive a do të ndikojë në zgjerimin e madhësisë së ndërmarrjeve në kushtet e shitjes, totalit të aktiveve dhe kapitalit, por analiza do na tregojnë se nuk ka ndonjë ndikim të rëndësishëm në fitimin e biznesit , kthimi marxhinal të kapitalit apo aseteve fikse.

### **1.3 Hipotezat**

Punimi është bazuar në analizën empirike dhe normative të studimit, duke analizuar të dhënat prej vitit 2008 deri 2019 të mikrokredive. Qëllimi kryesorë i punimit është që të konfirmojë ose hedh poshtë vlefshmërinë e hipotezave në vijim:

#### **Hipoteza kryesore H1:**

- Sistemi i analizës së mikrokreditimeve i bënë vendimet më efikase dhe eficiente.

#### **Hipoteza ndihmëse H1.1 :**

- H1.1:Thjeshtësimet byrokratike në këtë sistem mund të rritin efikasitetin dhe eficiencën

**Hipoteza kryesore 2:**Analiza e bazuar edhe në informacionet faktike dhe joformale redukton kreditë e këqija.

**Hipoteza ndihmëse H2.1:**

- Informacionet asimetrike ndihmojnë vërtetësinë e bonitetit dhe reduktojnë kreditë e këqija

Për konstatimin e validitetit të hipotezave do të aplikojmë qasjen narrative, krahasimore dhe kuantitative. Në vijim do të sqarojmë metodat që do të aplikohen në studimin tonë.

## 1.4 Metodologjia e hulumtimit

Qëllimi i këtij punimi shkencor është të përdoret **teknika e vlerësimit** të raporteve nga Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe disa pyetësorë të përgatitur për klientët e bankave dhe punonjësve bankar, për të analizuar bonitetin gjatë kredidhënies, me ndihmën e të cilëve është arritur deri në konkluzione dhe rekomandime .

Është përdorur **metoda e analizës**, punimi është bazuar në dokumente dhe raporte zyrtare , punime shkencore, libra të ekonomistëve të ndryshëm , ligjet e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe në procedurat dhe normat në lidhje me sistemin bankar në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Është përdorur **metoda statistikore**, ku në mënyrë kuantitative jepen tabela dhe grafikone të trendit të kredive dhe depozitave dhe kredive të këqija për disa vite të fundit .

Gjithashtu është përdorur **metoda komparative (krahasuese)**, ku analizohen shpjegon ritmin e fundit të kredive në Republikën e Maqedonisë së Veriut me fokus në pesë institucionet më të mëdha financiare në vend.

Metodë tjetër që është përdorur është **Pyetësori**. Kemi realizuar disa lloje të intervistës ku kemi zgjedhur 50 klientë dhe 110 bankier në nivele të ndryshme të hierarkisë së institucioneve



për të analizuar sistemin e analizës së mikrokredive tek vendimet e tyre , si arrihet efikasiteti dhe eficientia, thjeshtësimi byrokratik dhe informacionet faktike dhe joformale .

Gjithashtu që të arrihet qëllimi e këtij punimi shkencor në analizën e bonitetit dhe kredibilitetit të mikrokredive, janë përdorur referenca nga punime të ndryshme shkencore të viteve të fundit nga rajoni me qëllim të krahasimit të metodologjive të përcaktimit të bonitetit dhe kredibilitetit të mikrokredive dhe të krahasimit të trendëve botërore të kredive.

## 1.5 Struktura e punimit

**Në kreun e dytë** është bërë shqyrtimi e literaturës si dhe analiza e aspektit teorik, pse ekzistojnë bankat, roli i tyre në ekonominë e vendit si ndërmjetës financiar me fokus në angazhimin e bankave në aspektin e përcaktimit të bonitetit dhe kredibilitetit të mikrokredive Dhe më pas analizohen bankat që janë aktive në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe rejtingu i tyre në sistemin bankarë .

**Në kreun e tretë** fillimisht do të analizohet aspekti teorik si: definimi i kreditimit , proceset dhe llojet e kredive. Duke u bazuar edhe në përvojën personale gjatë angazhimit në sektorin financiar, në procesin e kredi dhënies nga institucionet financiare, do të shpjegohet çfarë roli luajnë produktet , zhvillimi i produkteve dhe shërbimeve financiare që përbejnë një faktorë të rëndësishëm duke u bërë sistemin financiar më të efektshëm , informatat kreditore që ndihmojnë deri te zgjedhja e kredive që të reduktojnë kreditë e këqija dhe definimin e mikrokredive, origjina e tyre. Faktorët e formimit të potencialit kreditorë dhe si institucionet financiare janë urë lidhëse mes nevojave të huadhënësve dhe huamarrësve si dhe rolin e funksioneve të tyre. Nga një shumëllojshmëri e skenarëve të humbjes së kredisë më e dukshme është moskthimi i interesit ose principalit për një detyrim të drejtpërdrejtë ose të kushtëzuar të kredisë. Në fakt, krahasuar me 30 vjet më parë, llojet e skenarëve të humbjes së kredisë që gjenden në huadhënien e korporatave dhe të biznesit sot kanë shërbyer për të revolucionuar se si zgjidhet kredia dhe vlerësohet risku.

**Në kreun e katërt** është analizuar një institucion financiar në të cilin kam pas qasje direkte si punonjëse e kreditimit me analiza të mikrokredive , paraqitja e shkurtër e historikut, strategjitë e praktikuara nga kursimorja, objektivat dhe procedurat. Tiparet e përcaktimit të mikro klientëve dhe ecurinë e kursimores dhe një analizë të bonitetit për tre vitet e fundit .

Një përkufizim më i ndryshëm por edhe përshkrues i kredisë është dhënë nga Colquitt J., i cili thotë se kredia është "përdorimi ose posedimi i mallrave ose shërbimeve pa pagesë të menjëhershme", që "kredia i mundëson një prodhuesi të tejkalojë hendekun midis prodhimit dhe shitjes së mallrave ", dhe se" pothuajse të gjitha shkëmbimet në prodhim, industri dhe shërbime kryhen me kredi. Prandaj, zgjerimi i kredisë do të ishte jo praktik sot, nëse jo i pamundur, pa ngjarjet që janë sjellë nga teknologjia dhe trendet e ndryshueshme në industrinë e shërbimeve financiare, të cilat të gjitha kanë ndryshuar në të vërtetë psikologjinë e zgjerimit të biznesit dhe kredisë korporative. (Colquitt J.2007 .Credit Risk Menagment page1,2)<sup>1</sup>

Llojet e skenarëve të humbjeve të kreditit që gjenden në huadhënien e bizneseve sot kanë shërbyer për të revolucionarizuar si zgjidhet kredia dhe vlerësohet. Rreziku kreditor paraqet rrezik të humbjes në bankë për shkak të pamundësisë së shfrytëzuesit të kredisë për të shlyer detyrimet në shumën e rënë dakord ose në afatet e paracaktuara.

Nga një këndvështrim praktik, rreziku i kredisë lind nëpërmjet mundësisë së pritjes në të ardhmen, kur flukset monetare të kredisë nuk mund të realizohen plotësisht.

---

<sup>1</sup> Colquitt J : 2007 .Credit Risk Menagment faqe 1,2

# KAPITULLI I: SEKTORI BANKAR NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË

## SË VERIUT

### 2.1 Pse ekzistojnë bankat? Teoria e ndërmjetësimit financiar

Në vitet e fundit , globalizimi i tregjeve financiare është zgjeruar me ritme të shpejta . Tregjet financiare kudo në botë janë integruar gjithnjë e më shumë<sup>2</sup>. Veprimtaritë në tregjet financiare kanë ndikim të drejtpërdrejtë në pasuritë e individëve, sjelljen e sipërmarrjeve dhe efikasitetin e ekonomisë tonë . Bankat dhe institucionet e tjera financiare i kanalizojnë fondet prej njerëzve të cilët mund të mos i investojnë ato në përdorim produktiv te njerëzit të cilët mund ta bëjnë këtë dhe kështu luajnë një rol vendimtar në përmirësimin e efikasitetit të ekonomisë.

Kur sistemi financiar ndalon dhe prodhon një krizë financiare , shoqëritë financiare falimentojnë rrjedhimisht duke i shkaktuar dëme të rënda ekonomisë<sup>3</sup>. Banka është një ndërmjetësues financiar , aktiviteti kryesor i të cilit është që të sigurojë kredi për huamarrësit dhe për të mbledhur depozita nga kursimtarët . Me fjalë të tjera ata veprojnë si ndërmjetësues midis huamarrësve dhe kursimtarëve , siç është ilustruar në Figurën 1.1

Duke kryer funksionin e ndërmjetësimit , bankat mbledhin fonde të tepërta nga kursimtarët ( Individët dhe kompanitë) dhe i ndajnë ato me ata që kanë një deficit të fondeve ( huamarrësit). Duke bërë këtë , ata kalojnë fondet nga kursimtarët tek huamarrësit duke rritur efikasitetin ekonomik dhe duke nxitur një shpërndarje më të mirë të burimeve .



Figura 1.1

<sup>2</sup> f.12: The Economics of Money, Banking, and Financial Markets, Frederic Mishkin, 2005

<sup>3</sup> f.13 The Economics of Money, Banking, and Financial Markets, Frederic Mishkin, 2005

Më parë bankat kanë qenë formueset e vetme të likuiditetit dhe bartëse të funksionit depozitar. Mirëpo, me zhvillimin e ekonomisë bashkëkohore, formohen një mori organizatash financiare, të cilat, krahas me bankat, luajnë rol të rëndësishëm në mobilizimin e mjeteve monetare dhe financimin e nevojave të ekonomisë<sup>4</sup>.

Esenca e konceptit bankë qëndron në marrjen dhe dhënien e kredive, e cila përshin si veprimtari kryesore, dy grupe themelore të punëve financiare të bankës:

- ❖ **Punët e formimit të parave**
- ❖ **Punët e ndërmjetësimit financiar**

Duhet potencuar dallimin konceptual mes bankave komerciale dhe popullore ose qendrore. Karakteristika kryesore e bankave popullore është se qëllimi i veprimtarisë së tyre nuk është fitimi, gjë që i bën këto të dallohen nga institucionet e tjera. Banka popullore kryen këto funksione:

- **Të drejtën e emisionit të parave (kartëmonedhave dhe monedhave) dhe të kredisë;**
- **Furnizimi i bankave komerciale dhe të shtetit me mjete të nevojshme monetare;**
- **Zbaton politikën kreditore monetare;**
- **Zbaton dhe kujdeset për politikën e likuiditetit ndërkombëtar;**
- **Krediton shtetin duke i lejuar kredi afatshkurtër ose afatgjatë.**

Derisa sipas konceptit të bankave komerciale – janë banka që bëjnë kreditimin afatshkurtër të prodhimit dhe konsumit. Këto banka mjetet i krijojnë mjetet prej depozitave afatshkurtër të

---

<sup>4</sup> f.4:Introduction to Banking, Barbara Casu,Claudia Girardone,Philip Molyneux,2015

ekonomisë dhe depozitave të kursimit të popullit . Karakteristikë e këtyre bankave është se kanë shumë komitentë dhe filiale të organizuara sipas principit territorial<sup>5</sup> .

## 2.2 Përshkrimi i sektorit bankar në Republikën e Maqedonisë së Veriut

Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut si bankë qendrore e vendit ka për objektiv kryesor ruajtjen e stabilitetit të çmimeve në tregun financiar, në atë që është i pavarur në kryerjen e funksioneve të tij. Banka mbështet politikën ekonomike dhe stabilitetin financiar të vendit, pa rrezikuar arritjen e objektivit kryesor, duke respektuar parimet e ekonomisë së tregut. Në përputhje me funksionet e parashikuara me ligj BPRMV realizon krijimin dhe zbatimin e politikës monetare. Në fund të vitit, në bazë të politikave të krijuara makroekonomike BPRMV përgatit një projeksion të zhvillimeve monetare për vitin e ardhshëm, i cili miratohet nga këshilli i BPRM.

### ▪ **Objektivat e politikës monetare**

Ruajtja e stabilitetit të çmimeve është objektiv kryesor i Bankës Popullore të Maqedonisë së Veriut, e themeluar me ligj. Vendosja e këtij qëllimi është në përputhje me gjetjet empirike konfirmuar se stabiliteti i çmimeve krijon ambient më të favorshëm makroekonomik për zhvillimin ekonomik të qëndrueshëm afatgjatë. Që nga vitit 1999, inflacioni në vend është matur nga indeksi i çmimeve me pakicë, dhe që nga viti 2000 monitorohet nga indeksi i kostos së jetesës. Për të arritur objektivin përfundimtar, Banka Qendrore vendos një objektiv të ndërmjetëm të politikës monetare.

Kështu, nga prilli 1992 deri në shtator 1995 BPRM aplikuar strategjinë e synimeve të dhënësit furnizimin me para M1, si një objektiv i ndërmjetëm i politikës monetare. Duke filluar nga tetori 1995 e tutje, Banka Qendrore zbaton strategjinë monetare të merrej me kursin nominal të këmbimit ndaj markës gjermane, dhe nga janari 2002 me euron. Prandaj, ruajtjen e

---

<sup>5</sup> f.28:Bankat dhe afarizmi financiar – dr.Gazmend Luboteni,2006

stabilitetit të kursit të këmbimit është një objektiv i ndërmjetëm i politikës monetare. Zbatimi i strategjisë së targetimit të kursit të këmbimit që rezultojnë nga:

- rëndësia e kursit të këmbimit në një ekonomi të vogël dhe të hapur;**
- nevoja për një spirancë nominale për të ruajtur besueshmërinë;**
- shkalla e lartë e euroizimit, dhe**
- transparencën e politikës së kursit të këmbimit dhe mundësinë e monitorimit të përditshme nga subjektet ekonomike.**

- ❶ Banka është përcaktuar në bazë të misionit, vizionit dhe vlerave organizative të Bankës Kombëtare, në përputhje me mjedisin makroekonomik dhe sfidat kryesore dhe ofron qëllimet themelore strategjike për tre vitet e ardhshme.
- ❷ Plani Strategjik rishikohet çdo vit dhe është bazë për përgatitja e Programit të Punës, të cilat përcaktojnë programet vjetore për të arritur qëllimet strategjike.

Plani strategjik përmban pikat e mëposhtme:

- **Projektuar Bilancit për tre vitet e tanishme dhe të ardhshme;**
  - **Plani i shpenzimeve operative për tre vitet e ardhshme; dhe**
  - **Korniza e investimeve të planifikuara për tri vitet e ardhshme.**
- ❸ Objektivi kryesor i Bankës Kombëtare është të arrijë dhe të ruajë stabilitetin e çmimeve. Një tjetër vartës. Qëllimi në objektivin kryesor, është të kontribuojë në mirëmbajtjen e një sistemi të qëndrueshëm, konkurrues dhe të bazuar në treg financiar, ndërsa objektivi i tretë është që të mbështesë politikat e përgjithshme ekonomike pa rrezikuar arritjen e objektivit kryesor dhe në përputhje me parimin e një tregu të hapur.
  - ❹ Misioni lind nga qëllimet e përcaktuara me ligj dhe shpreh angazhimin e Banka Kombëtare për të ruajtur stabilitetin e çmimeve me kryerjen e strategjia e zgjedhur monetare të ruajtur një normë të qëndrueshme të këmbimit kundrejt euros. Në të njëjtën kohë, Banka Kombëtare do të vazhdojë të kontribuojë për ruajtjen e stabilitetit financiar dhe rritjen e prosperitetit ekonomik dhe standardet e qytetarëve që jetojnë.
  - ❺ Vizioni i Bankës Kombëtare është që të njihet si institucion i pavarur, të përgjegjshme, profesionale dhe transparente që gëzon besim të lartë dhe besueshmërinë e publikut.

Banka Qendrore ka për qëllim ruajtjen e stabilitetit të çmimeve nëpërmjet një shkëmbimi të qëndrueshëm .

## **2.3 Vlerësimi i bonitetit të bankave, rejtingu i bankave dhe institucionet tjera financiare**

Sistemi bankar i Republikës së Maqedonisë së Veriut së përmban institucioneve financiare që janë pjesë e kuadrit institucional dhe rregullat ligjore që përbëjnë kuadrin ligjor. Kuadri institucional është i përbërë nga të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut ,

- A. Bankat komerciale**
- B. Bankat e kursimeve dhe**
- C. Fondi i Sigurimit të Depozitave.**

Bankat mbajnë një rol qendror në sistemin bankar dhe janë të rregulluara në bazë të Ligjit mbi Bankën Popullore të Maqedonisë së Veriut, ndërkohë që bankat komerciale të kryer aktivitetet e tyre në bazë të ligjit të përgjithshëm, Ligjit Bankar dhe ligjet dhe rregulloret tjera.

Sot sistemi bankar i Maqedonisë së Veriut përbëhet nga 15 banka tregtare dhe tre kursimore. Sistemi bankar i Republikës së Maqedonisë së Veriut përbëhet kryesisht nga kapitali i huaj që dominon më shumë se sa kapitali vendas, pra 75% e totalit të kapitalit aksionar është nga aksionarët e huaj.

Sipas statistikave të fundit të BPRMV, përkundër të gjitha sfidave ekonomike të tranzicionit, sistemi bankar ka ruajtur stabilitetin e tij, duke dëshmuar rezistencën e tij ndaj goditjeve të mjedisit të brendshëm dhe të jashtëm. Likuiditeti i sistemit bankar konsiderohet se është në nivel të kënaqshëm. Rreziku i kredisë (si një ndër rreziqet më të rëndësishëm në bilancet e bankave) nuk tregon një shqetësim në rritje.

Duke pasur parasysh faktin se euro (EUR) është monedha më e zakonshme e huaj në bilancet e bankave, ajo minimizon rëndësinë e rrezikut devizor për bankat. Kjo është për shkak

të dominimit të strategjisë për mbajtjen e një normë të qëndrueshme nominale të këmbimit në raport me denarë maqedonas kundrejt euros . Pavarësisht nga kjo, të gjitha bankat respektojnë kufirin në valutë të huaj (30% e fondeve të veta të bankës) . Megjithë stabilitetin e vlerësuar të sistemit bankar (financiar), BPRMV-së përcakton objektivat për periudhën e ardhshme dhe të gjitha masat e nevojshme të sigurisë për stabilitetin e sektorit bankar në Planin Strategjik të Bankës Qendrore për periudhën 2016-2018.

Reforma e sistemit bankar është e drejtuar nga rregullorja dhe standardet e BE. Për këto qëllime, Republika e Maqedonisë së Veriut vijon aktivitetet ndërkombëtare dhe diskutime mbi forcimin e kuadrit mbikëqyrës financiar dhe analizon kushtet për përdorimin e tyre.

**Tabela 1:** Numri i institucioneve financiar

| <b>Bankat</b>                         | <b>Shtëpите e kursimit</b>           | <b>Institucionet tjera financiare</b>                           |
|---------------------------------------|--------------------------------------|---|
| Komercijalna banka SH.A<br>Shkup      | Kursimorja FULM d.o.o. –<br>Shkup    | Subijekti elektronik i kliringut<br>“KIBS Sh.A. Shkup”          |
| NLB Banka SH.A Shkup                  | Kursimorja Mak- BS d.o.o.<br>Shkup   | Fondi i Sigurimit të<br>Depozitave, (KIBS) Shkup                |
| Stopanska Banka SH.A Shkup            | Kursimorja Mozhnosti d.o.o.<br>Shkup | Shkëmbimi i Bursës së<br>Maqedonisë (MSE)                       |
| Halk Bank SH.A Shkup                  |                                      | Agjensia e Menaxhimit të<br>pasurive të Maqedonisë së<br>Veriut |
| Ohridska Bank SH.A Shkup              |                                      | Agjensia e privatizimit   |
| ProCredit Bank SH.A Shkup             |                                      |   |
| Sparkase Bank Macedonia<br>SH.A Shkup |                                      |   |



|  |  |  |
|--|--|--|
| Stopanska Banka SH.A Bitola                            |  |  |
| Kapital Banka SH.A Shkup                               |  |  |
| Eurostandard Bank SH.A Shkup                           |  |  |
| Banka Koperative SH.A Shkup                            |  |  |
| TTK Bank SH.A Shkup                                    |  |  |
| Banka për zhvillimin e Maqedonisë së Veriut SH.A Shkup |  |  |
| Banka Univerzale e Investimeve SH.A Skopje             |  |  |
| Silk Road Banka SH.A Shkup                             |  |  |

*Burimi : Puna e vetë autorit bazuar në të dhënat e BPRM*

**Tabela 2:** Aktiva e 5 Bankave

| 5 Bankat më të sukseshme |                        |                                      |
|--------------------------|------------------------|--------------------------------------|
| Emri                     | Totali i aktives (EUR) | Pronë                                |
| Stopanska Banka          | 1.493                  | NBG (95%)                            |
| Komercijalna Banka       | 1.861                  | Struktura e aksionarëve të larmishëm |
| NLB Banka                | 1.334                  | Nova Ljubljanska Banka (87%)         |
| Halk Bank                | 767                    | Halk Bank (99%)                      |
| Ohridska Banka           | 644                    | Societe Generale (70%)               |

*Burimi : Puna e vetë autorit bazuar në të dhënat e BPRM*

Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut i ndan bankat në Maqedoninë e Veriut në tre grupe, të matura sipas totalit të aktiveve, si më poshtë: të mëdha, të mesme dhe të vogla. Në vitin 2018, grupet e veçanta përbënin bankat në vijim:

**Tabela 3 : Grupi i bankave**

| Grupi i bankave të mëdha<br>(aktive më të mëdha se 34.8<br>miliardë denarë më 31 dhjetor<br>2018) | Grupi i Bankës së Mesme<br>(aktivet ndërmjet 8.65 dhe<br>34.8 miliardë denarë me<br>31.12.2018) | Grupi i bankave të vogla<br>(aktivet më pak se 8.65<br>miliardë denarë me<br>31.12.2018) |
|---|---|--|
| Pesë banka  | Shtatë banka  | Tre banka  |

Burimi : Puna e vetë autorit bazuar në të dhënat e BPRM

**Bankat e mëdha** - Komercijalna Banka SH.A Shkup, Stopanska Banka SH.A Shkup, NLB Tutunska Banka SH.A Shkup , Halk Banka SH.A Shkup , Ohridska Banka .

**Bankat e mesme** - ProCredit Banka, Stopanska Banka SH.A Bitola , Banka Koperative CSH.A Shkup , Uni Banka SH.A Shkup, Sparkasse Bank Makedonija SH.A Shkup. Banka e Investimeve Universale SHA Shkup, Banka Maqedonase për Mbështetje të Zhvillim SHA Shkup

**Bankat e vogla** - TTK Banka SH.A Shkup , Eurostandard Banka SH.A Shkup, Banka Kapitale SH.A Shkup,

Sipas shkallës së privatizimit, bankat në Republikën e Maqedonisë dominojnë kapitalin privat me mbi 95%, duke përjashtuar Bankën Maqedonase për Promovimin e Zhvillimit SHA Shkup, e cila është në pronësi të plotë shtetërore. Në strukturën e pronësisë së bankave, kapitali i huaj merr pjesë me 74.2%. Bankat në pronësi dominante të aksionarëve të huaj mbetet dominuese në sistemin bankar vendas, një total prej pesëmbëdhjetë (15), njëmbëdhjetë (11) bankat në pronësi të huaj dominuese.<sup>6</sup>

<sup>6</sup>Për më shumë rreth bankave në Republikën e Maqedonisë së Veriut në linkun vijues:

Bankat, të cilat janë kryesisht në pronësi të huaj, kanë një rol dominues në pozicionet e rëndësishme të bilancit të sistemit bankar. Të vetmet banka që ende kanë pronësi dominuese të vendit: TTK ku dominant grup aksionar Teteks Tetovë 47.2%, Banka Industriale SH.A Bitola, ku pronari mbizotërues është Pelisterka SH.A - 21,85%.

## 2.4 Depozitat dhe kreditë

Në tablen e bashkangjitur kemi marrë një analizë për 6 vite me rradhë prej viti 2013-2019 , që nga raporti i dhenë vërejm ndryshime si tek depozitet dhe kreditet kemi rritje çdo vite e më shumë .Në vitin 2017 nuk ka pasur ndryshime të rëndësishme në nivelin e rrezikut të kredisë në sistemin bankar, pavarësisht nga materializimi i rrezikut nga disa klientë të mëdhej. Për sektorët, rreziku më i rëndësishëm i kredisë për bankat vazhdon të jetë sektori i korporatave, pjesa e të cilit në kreditë me problem 11 është 10% si me 31 Dhjetor 2017 dhe është më e madhe se 2016. Rritja ose kjo pjesë ishte për shkak të rritjes më të theksuar të kredive me probleme në lidhje me zhvillimin e aktivitetit kreditor të bankave drejt këtij segmenti të tregu i kredisë. Rreziku i kredisë nga vendosjet e bankave të familjet është i ulët - norma e kredive me probleme u ul në nivelin më të ulët historik prej 2.4%.<sup>7</sup>

Bankat kanë kapacitete të mira për t'u marrë me rrezikun e kredisë .Rregullimi dhe mbikëqyrja e kujdesshme, megjithatë gjithashtu qasja e kujdesshme e bankave gjatë matjes së rrezikut të kredisë parashikojnë mbulim të lartë i kredive me probleme me zhvlerësim të alokuar dhe për minimizim të rreziqeve për aftësinë paguese të bankave nga përfundimi eventual mospagueshmëri. Në vitin 2017 Banka Kombëtare hartoi një strategji për stimulimin e që kanë të bëjnë me dhe përmirësojnë menaxhimin e kredive me probleme.

Megjithatë mund të vërejm çdo vite kemi rritje në numrin e kredive , totali i tyre në vitin 2018 ka arritur 5.205 , për shkak të rritjes të kredisë ende mundet të vërejm se vleresimet e

---

<http://www.nbrm.mk>

<sup>7</sup> Për më shumë informata rreth raportit të depozitave dhe kredive në linkun vijues:

<https://mba.mk/w/wp-content/uploads/2019/05/Presentation-Macedonian-Banking-Sector-Overview-May-2019>

profilin të rrezikut të kredise se bankave është në rruajte të stabilitetit nuk ka përkeqesim të <sup>8</sup>ketij treguesit të cilësisë së segmentit të protofolit të kredive të keqija . Në të njejtën kohë kemi rritje dhe në totalin e depoziteve në vitin 2017 kanë qenë 5.518 ndërsa në 2018 ka arritur në 8.187. Raporti i huave / depozitave në ana tjetër në 2018 ishte 85.9% e cila siguron vend për aktivitete të mëtejshme të huadhënies të bankave .

**Tabela 4 : Treguesit e qëndrueshmërisë bankare**


| Treguesit e qëndrueshmërisë bankare (EUR)     | 2013   | 2014   | 2015   | 2016   | 2017   | 2018   | 2019   |
|---|--------|--------|--------|--------|--------|--------|--------|
| Totali i Aktivës                              | 6.007  | 6.511  | 6.878  | 7.233  | 7.513  | 8.187  | 8.942  |
| Totali i Depoziteve                           | 4.215  | 4.668  | 4.971  | 5.25   | 5.518  | 6.038  | 6.594  |
| Depozitat e korporatave                       | 988    | 1.15   | 1.301  | 1.469  | 1.504  | 1.642  | 1.802  |
| Totali i kredive                              | 3.741  | 4.115  | 4.506  | 4.57   | 4.839  | 5.205  | 5.523  |
| Kredit e korporatave                          | 2.198  | 2.389  | 2.553  | 2.459  | 2.529  | 2.647  | 2.849  |
| Raporti NPL                                   | 11.50% | 11.30% | 10.80% | 6.60%  | 6.30%  | 5.20%  | 4.30%  |
| Raporti i Përshtatshmërisë së Kapitalit (CAR) | 16.80% | 15.70% | 15.50% | 15.20% | 15.70% | 16.50% | 16.30% |
| Kthimi nga kapitali (ROE)                     | 5.70%  | 7.40%  | 10.40% | 13.60% | 13.50% | 16.00% | 16.50% |
| Kthimi I pasurive (ROA)                       | 0.60%  | 0.80%  | 1.10%  | 1.50%  | 1.40%  | 1.70%  | 1.75%  |
| Raporti I kredive me depozit                  | 89.70% | 89.40% | 91.90% | 87.80% | 88.00% | 85.90% | 83.75% |
| Raporti i Kostos ndaj të Ardhurave            | 60.60% | 55.50% | 51.60% | 49.80% | 48.70% | 46.20% | 45.70% |
| Marzhi neto i interesit                       | 3.40%  | 3.40%  | 3.50%  | 3.50%  | 3.40%  | 3.20%  | 3.10%  |

Burimi : Puna e vetë autorit bazuar në të dhënat e MBA (MACEDONIAN BANKING ASSOCIATION)

**Figura 1 : Kreditet dhe Depozitat në BPV**

<sup>8</sup> Report on the risk in the banking system of the Republic of Macedonia in 2019  
<https://www.nbrm.mk/content/godisenbankarskisistem>


### Kreditet dhe depozitat në Bruto prodhimin vendor



Burimi : Puna e vetë autorit bazuar në të dhënat e MBA (MACEDONIAN BANKING ASSOCIATION)

Figura 2 : Kreditet dhe Depozitat (rritja vjetore )

### Kreditet & depozitet (rritja vjetore)



Burimi : Puna e vetë autorit bazuar në të dhënat e MBA (MACEDONIAN BANKING ASSOCIATION)


Nga grafikoni më larte do të shohim se si huatë dhe depozitat kanë përjetuar një ngadalsim në vitin 2016 kjo ishte si rezultat i krizës politike dhe pasigurisë që ishte në vendin

tonë , po këta indikatorë nisen shërimit të tyre përseri në vitin 2017 që vërejm se në vitin 2018 kemi dukshëm një rritje që huatë arrin deri 7.3% dhe depozitat deri në 10.5% .

Në vitin 2017, institucionet financiare operonin në kushte të pasigurisë politike, e cila rezultoi në stagnacion ekonomik, me zhvillime pozitive në gjysmën e dytë të vitit. Duke pasur parasysh normat e ulëta të interesit, segmentet e analizuar të sistemit financiar (duke përjashtuar shtëpitë brokere dhe kompanitë financiare) kanë pasur një rezultat financiar pozitiv, dhe norma e kthimit mbi aktivet mesatare dhe kapitalit mesatar janë mbajtur në një nivel solid.


Mbajtja e operimeve me përfitim mes rendimenteve të ulëta nga investimet financiare kërkon përmirësimin e vazhdueshëm të kapaciteteve, por edhe përshtatjen e modeleve të biznesit të institucioneve financiare, përmirësimin e informatik, teknik dhe të marketingut të tyre dhe përmirësimin e konkurrencës. Rreziku strategjik është mjaft i rëndësishëm për disa segmente të sistemit financiar (kryesisht kompanitë e lising-ut, shtëpitë brokere, kështu edhe shtëpitë e kursimit), të cilat janë përballur me konkurrencën nga bankat.

**Figura 3 :** Kreditet ndaj kompanive dhe familjeve




Burimi : Puna e vetë autorit bazuar në të dhënat e BPRMV

**Figura 4 : Kushtet dhe kerkesa për kredi**



Burimi : Puna e vetë autorit bazuar në të dhënat e BPRMV

**Figura 5 : Kreditet e PP**



Burimi : Puna e vetë autorit bazuar në të dhënat e BPRMV

## KAPITULLI II: KREDITIMI , DEFINIMI , PROÇESI DHE LLOJET , ME THEKS TË VEÇANT NË MIKROKREDITIM

### 3.1 Procesi i kredisë

Sipas kriterëve të funksionalitetit të plasmanit , përkatësisht punët kreditore paraqesin grupin e dytë të punëve kryesore të bankës , në të cilat bankat ndaj komitentëve që u lejon kredi paraqitet si kreditor .Bankës prej mjeteve të koncentruara dhe të mobilizuara i bëhet e mundshme që të jep mjetet në formë të kredisë .

Punët aktive bankare , përkatësisht punët kreditore ndahen në kredi me afat të shkurtër dhe afat të gjatë . Kredia afatshkurtër për dallim nga ato afatgjate që kryesisht kanë të bëjnë me investime afatgjate , u lejohet shfrytëzuzve (deborëve ) për plotësimin e nevojave afatshkurtra të tyre për mjetet qarkulluese .Këto kredi kthehen në afate të shkurtë , në raste të jashtezakonshme banka mund ta bëjë transformimin e strukturës së afateve në kredi me afat të gjatë .<sup>9</sup>

### 3.2 Tipet e kredisë

Kreditë janë ndër aktivitetet kryesore të bankës , prej nga banka klientëve u lejon mjete financiare. Me një fjalë, kreditimi i individëve , biznesit dhe subjekteve të tjera të cilat kërkojnë kredi në bankë është procesi i dhënies hua të fondeve te vendosura në banke , i cili bazohet sipas kushteve të rëna dakord midis vetë bankës dhe të huamarrësve. Funkzioni i kreditimit të mjeteve çfarë i dedikohet klientëve është funksioni kryesor i përdorimit të fondeve financiare .

Aktivitetet kryesore të bankave komerciale dhe kursimoreve është dhënia e kredive për klientët e tyre . Në sferën e veprimit të sistemit kreditor te Maqedonisë, për klientët e vet , bankat komerciale të cilat funksionojnë dhe që ushtrojnë aktivitetin e tyre ofrojnë këto lloje të kredive:

---

<sup>9</sup> f.194,195:Financat ,Prof.dr. Sabahudin Komoni , 2008



#### **a) Kredi konsumatore të llojeve të ndryshme :**

Këto kredi janë të gjitha kreditë që i janë aprovuar popullatës për financim të konsumit aktual si dhe blerja e harxhimeve të qëndrueshme. Këto kredi janë të ndryshme në varësi të qëllimit, pjekurisë, mënyrës se shlyerjes etj.

Sipas qëllimit, huatë e konsumatorit grupohen si: **kredi të rinovueshme , kredi të caktuara të konsumatorit, kredi jo të caktuara , kredi për vetura , kredi dhe lloje të tjera të kredive konsumatore (kredi turistike, kredi për shkollimin, etj).** Sipas metodës së shlyerjes, ata kanë pjesën më të madhe kredi me shlyerje periodike ndërsa një përqindje më e vogël është hua me shlyerja e njëhershme.

#### **b) Kredi qarkulluese(rrjedhëse):**

Ky grup përfshin kredi për karta krediti që lejohen mbitërheqjet në llogaritë rrjedhëse, etj. Me këto kredi konsumatori ka linjë krediti të hapur të një shume të caktuar. “Shembull Për një hua të tillë në Republikën e Maqedonisë është "OK-kredia" e Stopanska Banka” ,ku konsumatori merr një kartë që mund të tërheq para në arkë ose ATM(bankomat) por nuk mund të blejnë produkte në tregti dyqane. Huadhënësi ka një shumë fikse në këto kredi të rinovueshme huazimi dhe pasi të shlyhet borxhi, kredia rinovohet.<sup>10</sup> Këto kredi nuk kanë kohë të caktuar sepse ato vazhdimisht zgjaten. Në varësi të shlyerjet, paraqiten si kredi të ripaguara në këste ose shlyerja e njëhershme.

#### **c) Kredi për qëllime të caktuara**

Këto kredi miratohen në baza kontraktuale midis bankave dhe bankave tregtare ndërmarrjet dhe ato kanë për qëllim të blejnë produkte nga dyqane të caktuara (teknikë e bardhë, teknikë video dhe audio, mobilje, veshje, bizhuteri, etj.). Sasia e këtyre Kreditë në vendin tonë mund të variojnë nga rreth 15,000 deri në 300,000 denarë. Konsumatori zakonisht

---

<sup>10</sup> Për më shumë informata rreth OK kredisë shëbehuni me linkun vijues:  
<http://www.stb.mk>

nuk i merr paratë, por paratë shkojnë direkt nga bankat në llogarinë e shitësit. Këto kredi mund të jenë edhe afatshkurtra dhe afatgjatë . Afati afatshkurtër zakonisht është me një normë konstante interesi, ndërsa ato afatgjata kanë norma të luhatshme të interesit. Përveç normës së interesit ato janë ngarkuar tarifa të tjera të ndryshme si kosto manipuluese për aprovimi, kostot e ripagimit të parakohshëm, etj. Më së shpeshti hasen si kredi për pagesa me këste .

#### **d) Kredi për vetura**

Këto kredi miratohen për blerjen e makinave, motorëve të rinj ose të vjetër dhe automjetet jashtë rrugës. Këto kredi miratohen si kredi në valutë në mënyrë që të mbrojnë bankat nga rreziku i këmbimit valutor (valutë), duke marrë parasysh që këto kredi janë kredi me një maturim më të gjatë (zakonisht një deri në gjashtë vjet). Kur miraton këto kredi, banka i paguan paratë shitësit të makinës, dhe shlyerja e huasë bëhet në muaj të barabartë. Zakonisht miratohen nga 18,000 në 3,100,000 denarë, me ç'rast huamarrësit zakonisht kërkohet të ketë një normë interesi rreth 20% vlera totale e automjetit që blihet. Kreditë për vetura i përkasin grupi i kredive të siguruara zakonisht sigurohet nga pengu i automjetit e cila është blerë si dhe kolaterali Casco në favor të bankës lëshuese. Ndalim administrativ mbi pagën, kambial, faturë, një ose dy garantues, depozitë në denar ose në valutë të huaj, hipotekë e pasurive të paluajtshme pronës.

Varesisht prej mënyres së lejimit dhe të shfrytëzimit , paraqiten këto forma të kredisë afatshkurter:

- ❖ **Kredi ne llogari rrjedhese**
- ❖ **Kredi eskontuese**
- ❖ **Kredia lombarde**
- ❖ **Kredia ramburse**
- ❖ **Kredia akceptuese**
- ❖ **Kredia vinkulacionuese**
- ❖ **Kredia avaluese**

#### **e) Kredi të tjera konsumatore**

Bankat në vendin tonë ofrojnë edhe kredi të tjera konsumatore me të ndryshme të destinuara për konsumatorët. Ekziston një përqindje e madhe e njerëzve në vendin tonë që nuk mundën për të përballuar pushime ose udhëtime jashtë vendit. Kjo është arsyeja pse ofrohen kredi të shumta për të mundësuar njerëzit të plotësojnë nevojat e tyre. Ata janë kredi afatshkurtër, të ripagueshme në këste të barabarta mujore, me fikse ose normat e ndryshueshme të interesit dhe pajisen me një ndalim të pagës administrative ose me notë premtuese.

Një lloj tjetër i kredive të tilla janë kreditë shkollore që u jepen studentëve , si dhe studentëve mundësinë për të shlyer shpenzimet e tyre në Maqedonia dhe jashtë saj. Huatë e konsumatorit janë më fitimprurëse për bankat . Në vitin 2016 shkalla e kredite për konsumatorë zënë mesatarisht rreth 11 %, për dallim nga kreditë dhënë për ndërmarrjet ku norma mesatare është diku rreth 9%. Normat e interesit të kartave të kreditit janë rreth 12%. Interes i lartë normat që këto kredi kanë sigurisht që janë rezultat i primit të rrezikut që ato janë shton normën e interesit e cila është më e lartë për shkak të kredisë më të lartë rrezik, atëherë bankat kanë kosto më të larta operative kur i aprovojnë këto kredi, si dhe fakti që kamata më të larta mund të vendosen për shkak të pandjeshmëria e interesit të konsumatorit.

#### **f) Kredi banesore**

Kreditë për shtëpi janë pjesë e kredive për pasuri të paluajtshme. Ato janë afatgjata hua të siguruara nga hipotekat e pasurive të paluajtshme. Bankat i aprovojnë këto kredi për qëllimet e mëposhtme: blerja e një apartamenti ose shtëpie, blerja e një shtëpie me tokë, rinovimi i një apartamenti ose shtëpie, ndërtimi, shtrirja dhe renovim i një shtëpie etj. Këto kredi nga pikëpamja e maturimit janë kreditë afatgjata me një afat prej 5 deri në 30 vjet.

Ato i përkasin grupit të kredive të siguruara nga pasuritë e paluajtshme pronë (kredi hipotekare). Me anë të shlyerjes këto kredi janë kredi të cilat paguhen me këste. Kreditë hipotekare në vendin tonë nuk kishin përqindje më të lartë prej pavarësisë se Maqedonisë, por

vitet e fundit këta kredi bankare po rriten me shpejtësi<sup>11</sup>. Llojet e kredive që bankat u japin ndërmarrjeve.

Rreth një e katërta e totalit të aktiveve të bankave në Republikën e Maqedonisë i referohet kredive të ndryshme që ata u japin klientëve të tyre ajo është pothuajse dyfishi i pjesës së kredive në asetet e Maqedonisë bankat për sa i përket pjesëmarrjes së kapitalit të bankave në vendet e zhvilluara ku dy e treta e të ardhurave të tyre vijnë nga aktivitetet e huazimit. Zakonisht janë grupuar në dy lloje: kredi afatshkurtër dhe afatgjatë. Nisur nga rregulloret tek vendi ynë, bankat mund të aprovojnë kredi brenda dhe jashtë vendit kredi në monedhë, d.m.th. në monedhë të huaj dhe në valutë.

E para është sepse ato janë kredi afatgjata që u ofrojnë bankave mundësinë për tu mbrojtur nga rreziku i këmbimit valutor dhe arsyeja e dytë është se këto kredi janë gjithmonë të siguruara nga prona e hipotekuar që nënkupton çmimet e pronave këtu shprehen në euro. Shuma e këtyre kredive varion nga 3.000 deri në 150,000 EUR, dhe pjekuria është bindëse më e gjata, ndryshe nga llojet e tjera kredi bankare. Deri disa vjet më parë një hipotekë merrej si kolateral në një pronë tjetër, por sot mund të merret vetë apartamenti ose shtëpia. Shlyerja e kësaj kredie është në këste të barabarta mujore i jep debitorit një plan amortizimi për shlyerjen. Shumica e bankave lejojnë dhe shlyerjen e parakohshme të kësaj kredie.

#### **g) Kredi afatshkurtëra**

Kreditë afatshkurtra dhënë korporatave marrin pjesë rregullisht me rreth tre të pestat e gjithsej kredive të dhëna për bankat. E tillë është situata si rezultat i kërkesës më intensive për kredi të korporatave në aktivë për të përmbushur nevojat e përkohshme dhe sezonale të pasurive rrjedhëse dhe vëllimi i pamjaftueshëm i burimeve afatgjata të fondeve. Bankat në Republikën e Maqedonisë janë më të interesuara gjatë miratimit të kredive afatshkurtra për shkak të rrezikut të tyre të ulët të ripagimit, sidomos me ekzistimin e kolateralit për të përdorur një numër relativisht të detyrimeve. Kjo është arsyeja pse shumica e kredive afatshkurtra të bankave i referohen huave të kapitalit punues për ndërmarrjet.

---

<sup>11</sup> f.25,26:Politika kreditore,Violeta.M,2011

#### **h) Kredi afatgjata**

Kreditë afatgjata miratohen me një periudhë shlyerjeje më shumë se një vit. Ato shërbejnë për të financuar nevoja relativisht afatgjata . Kjo imponon nevojën për një mbulim real (peng) të ndryshëm. të kredive që shihet zakonisht në kompani të ndryshme të pasurive të patundshme. Afati i gjatë i shlyerja e kredive, si dhe realizimi jashtëzakonisht i ngadaltë dhe i pasigurt i përcakton kolateralin e ofruar në rast të mospagimit të këtyre kredive rreziku dukshëm më i lartë i këtyre kredive në krahasim me një afat të shkurtër .

#### **i) Kredi për investime**

Kredi për investime (me afat) të destinuara për blerja e pajisjeve dhe makinerive ose për ndërtimin e ndërtesave. Për realizimin e tyre bankat kohët e fundit kanë përdorur linja kredie të qeverive , përmes mbështetjes së Bankës së Maqedonisë Veriut për zhvillim) ose nga një organizatë ndërkombëtare financiare (për shembull, linja krediti për financimin e projekteve të caktuara të Maqedonis së Veritu që miratohet në mënyrë periodike nga Banka Botërore).

#### **j) Kredi për projekte speciale**

Kredi për projekte speciale që për shkak të angazhimit të shumave të mëdha të fondeve dhe për shkak të jetëgjatësisë së performancës së projektit, konsiderohen kreditë më të rrezikshme. Këto kredi zakonisht ofrohen nga bankat në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe aprovojnë përdorimin e një linje kredie nga një bankë e huaj (për shembull, linja e kredisë e aprovuar nga qeveria kineze është përdorur për të ndërtimi i hidrocentralit "Kozjak").

#### **k) Kredi qarkulluese afatmesme**

Këto kredi janë shumë të ngjashme me linjat e kredisë dhe përfaqësojnë forma kalimtare ndërmjet kredive afatshkurtra dhe atyre afatgjata sepse ato mbulojnë një periudhë nga 2 deri në 5 vjet. Banka dhe klienti bien dakord për shumën e kredisë e cila mund të përdoret gjatë një periudhe kohe, kompania merr hua kur asaj i duhen mjete dhe aq mjete sa i duhen.

Më vonë, kur debitori bën pagesa në para, ai kthen vetëm një pjesë të kredisë, kështu që kjo kredi zgjatet automatikisht. Dhe në rastin e huave afatgjata, rregulli është të aprovohen ato me norma të interesit të ndryshme në varësi të vlerësimit të rrezikut të investimit (projekti), besueshmëria e huamarrësit, kohëzgjatja e periudhës së ripagimit etj. Nëse fondet e huaja

përdoren për të financuar ato qëllime me linjat e kreditit, atëherë shumica e normës së interesit formohet në varësi të kushteve të përcaktuara nga huadhënësi i huaj në kontratë.

### 3.3 Politika e kredidhënies dhe procedura

Biznesi i huadhënies është një marrëdhënie reciproke: aktualisht një bankë ju jep para për t'u ndihmuar në të ardhmen supozohet se klientët do ti ripaguani ato para me interes. Në këtë fazë ne do të shpjegojmë politikat e kredidhënies dhe procedurat edhe pse çdo bankë ka politika të caktuara që ndryshojnë nga të tjerët po përafërsisht gati se të gjitha bankat janë të përafërta në të cilën ndryshon norma kamatore, kërkimi i dokumenteve e gjitha përcaktohet nga kredia. Kryesisht bankat udhëhiqen nga politikat dhe procedura që i vendosin ata në kushte që të shfrytëzohen në mënyrë efektive dhe janë treguesit e ecjes së punës bankare që të vlejë për rrjedhjen e detyrimeve dhe për të përcaktuar qëllimet e punës bankiere si dhe dhënies së kredise.<sup>12</sup>

Procesi i huadhënies përfshin një numër aktivitete të kryera nga punonjësit dhe menaxherët në nivele të ndryshme të bankës. Zyrtarisht, procesi i huadhënies fillon që nga momenti kur klienti aplikon për një kredi, megjithëse tashmë janë kryer aktivitete të shumta.

Banka duhet të kryejë hulumtime të tregut mbi baza të vazhdueshme për të identifikuar nevojat dhe mundësitë e klientit për dhënien e kredive të reja me një kthim të pranueshëm të rrezikut. Për këtë qëllim, banka analizon tendencat aktuale në ekonomi (dhe veçmas, në sektorë të çaktuar), parashikon kërkesën për kredi në të ardhmen, analizon tendencat në lloje të caktuara të produkteve të kredisë, analizon konkurrencën, etj.<sup>13</sup>

Procesi i huazimit fillon kur klienti vendos të aplikojë për një kredi. Gjatë aplikimit të klientit është e zakonshme që huadhënësi (punonjësi i kredisë) faza fillestare është që zyrtari i huasë të intervistojë së pari kredimarrësin. Intervista shërben si një shkëmbim i dyanshëm i informacionit fillestar midis bankës dhe klientit, e cila është e rëndësishme për të marrë një

---

<sup>12</sup> Si t'i Drejtoresh një Banke , Pro Credit Bank [file:///C:/Users/X/Desktop/Si ti drejtoresh nje banke.pdf](file:///C:/Users/X/Desktop/Si%20ti%20drejtoresh%20nje%20banke.pdf)

<sup>13</sup> F.97 : Goran Petrovski , Uparuvanje so banki (vtora izdanje ) Skopje ; Ekonomski Fakultet ,2011

pamje të qëllimeve të kompanisë (apo klientin si person fizik ) dhe aftësinë dhe gatishmërinë e saj për të shlyer kredinë në kohë. Kredidhënesi e informon huamarrësin për kushtet dhe procedurën e huazimit: shumën e kredisë, normën e interesit, komisionet dhe shpenzimet e tjera, periudhën e shlyerjes, kolateralin, kohëzgjatjen e procedurës, dokumentacionin e kërkuar, etj.

Mikrokreditimi është pjesë e mikrofinancës, e cila ofron një gamë më të gjerë shërbimesh financiare, veçanërisht llogaritë e kursimeve, për të varfrit. Në përgjithësi, mikrokredia moderne është konsideruar të ketë origjinën nga Banka Grameen e themeluar në Bangladesh në vitin 1983. Origjina e mikrokredisë në mishërimin e tanishëm praktik mund të lidhet me disa organizata të themeluara në Bangladesh, veçanërisht Bankën Grameen. Banka Grameen, e cila në përgjithësi konsiderohet institucioni i parë modern i mikrokredisë, u themelua në vitin 1983 nga Muhammed Yunus. [3] Yunus filloi projektin në një qytet të vogël të quajtur Jobra, duke

---

<sup>36</sup> F.133 : ECONOMICUS NR5/2010 Revistë Shkencore e Fakultetit Ekonomik

përdorur paratë e tij për të dhënë hua të vogla me norma të ulëta interesi për të varfërit rural. Grameen Bank u pasua nga organizata të tilla si BRAC në 1972 dhe ASA në 1978.<sup>37</sup>

Mikroreditimi shpejt u bë një mjet popullor për zhvillimin ekonomik, me qindra institucione që dilnin në të gjithë botën e tretë.<sup>38</sup> Megjithëse Banka Grameen u formua fillimisht si një organizatë jofitimprurëse e varur nga subvencionet qeveritare, ajo më vonë u bë një njësi ekonomike dhe u emërtua Grameen II në vitin 2002<sup>39</sup>. Muhammad Yunus u nderua me Çmimin Nobel për Paqe në vitin 2006 për punën e tij duke ofruar shërbime të mikrokredisë për të varfërit. Koncepti “mikrofinancë” nuk është më koncept i ri në botën e financës, ai gjithnjë e më shumë po përdoret si një term, i cili e identifikon atë me popullatat e varfra apo vulnerabile, pa akses ose me akses të kufizuar në shërbimet e institucioneve bankare. Termi “mikrofinancë” përmbledh shumë elementë, ku një nga më të përhapurit është mikrokredia që shpesh shoqërohet me paketa speciale kursimi dhe sigurimi, të drejtuara dhe të adoptuara për nevojat e njerëzve të varfër dhe me të ardhura të ulta.

Klientët tipik të mikrofinancës janë të varfërit dhe njerëzit me të ardhura të ulëta, që nuk kanë akses në institucionet e tjera formale financiare. Ndonëse nuk ka shumë të dhëna rreth universit të klientëve potencialë, numri i ekonomive familjare pa akses efektiv për shërbime financiare është jashtëzakonisht i madh. Mikrofinanca është një sipërmarrje që ka provuar aftësinë për të nxjerrë njerëzit nga varfëria. Me formulat e saj origjinale, ajo bën që burimet financiare të jenë të arritshme për bizneset e vogla dhe të mesme, të cilat përbëjnë pjesën më të madhe të prodhimit. Këto burime shpesh përdoren për të financuar projekte të vogla në fusha të tilla, si bujqësi, blegtori apo shërbime si artizanale, ushqimore të vogla etj .

Mikrokredia, ndryshe nga institucionet e tjera huadhënëse nuk kërkon që klientët të kenë kolateral, të jenë në marrëdhënie pune apo të kenë histori kredie për të patur mundësi të marrin hua. Kjo përbën një avantazh të mikrokredisë dhe në të njëjtën kohë edhe një lehtësi e

---


<sup>37</sup> Drake, Deborah (2002). *The Commercialization of Microfinance*. Kumarian.

<sup>38</sup> Bateman, Milford (2010). *Why Doesn't Microfinance Work?*. Zed Books

<sup>39</sup> Spooner, Lysander (1846). "Poverty : Its illegal causes and legal care ". Boston. Archived from the original on October 25, 2012. Retrieved January 30, 2012



cila u lejon njerëzve të marrin kredi, gjë që nuk do ishte e mundur të merrej në institucionet financiare tradicionale.



Ekonomitë familjare që përbëjnë 10 përqindëshin më të varfër të popullsisë, nuk janë klientë tradicionalë të mikrokredisë sepse mungon qëndrueshmëria e cash flow-t të tyre. Mikrofinanca është e papërshtatshme për këtë kategori të popullsisë që ka nevojë për grante ose burime nga institucione të tjera publike për të përmirësuar situatën e tyre ekonomike. Ndihamat, janë mënyra më efçente për të trasferuar burime tek shumë të varfërit, sesa kreditë që shumë prej tyre nuk janë në gjëndje që t’i paguajnë.

Në plotësim të teknikave të mëparshme, teoria e mikrokredisë është munduar të përcaktojë mjete që do të shmangnin disa nga rrisqet tradicionale të kredisë, duke u fokusuar në edukimin më të mirë të disiplinës së shlyerjeve dhe ngarkimin e normave të interesit që mbulojnë kostot e shpërndarjes së kredive. Të dyja këto mbështesin zhvillimin e institucioneve të mikrofinancës, të aftë për të vazhduar të shtrijnë shërbimet e tyre në të ardhmen.

Mikrofinanca ka ardhur duke u rritur me shpejtësi. Sipas të dhënave të CGAP (Grupi Konsultativ për Asistimin e të Varfërve) portofoli i mikrokredisë në botë llogaritet në vlerën e rreth 25 miliardë dollarëve, por gjykohet që industria ka nevojë për 250 miliardë dollarë për të plotësuar nevojat e të gjithë njerëzve të varfër që kanë nevojë për të. Në vitin 2006, rezultonte

se Institucionet e Mikrokredisë u shërbenin mbi 113 milionë klientëve në mbarë botën, ndërsa deri në vitin 2015 ky shërbim pritet të prekë shifrën e 175 milionë klientëve. Ndoshta arsyeja, që ka kaq shumë entuziazëm për mikrofinancën dhe sidomos për shërbimin financiar të mikrokredisë tregon se ajo është një mekanizëm i bazuar në treg që ka arritur disa suksese aty ku mekanizma të tjerë nuk ia kanë dalë.<sup>40</sup>

Sot, institucionet mikrofinanciare operojnë si institucione të pavarura me një numër klientësh gjithnjë e në rritje. Bankat gjithashtu, po tregojnë një farë interesi në mikrofinancim, por në një nivel të ulët, kjo mund të shpjegohet nga ngushtimi i konkurrencës në treg dhe nga nevoja për të eksploruar mundësi të reja investimi. Bankat janë veçanërisht aktive në mikrofinancimin në zonat urbane .

Vlerësimi i riskut bëhet më i vështirë dhe kjo gjë rrit rëndësinë e monitorimit të kredisë nga huadhënësit, duke përfshirë përpjekje efektive të mbledhjes së kredive pas daljes me vonesa. Ky ambient ku veprojnë institucionet mikrofinanciare përfaqëson mundësi dhe kërcënime për to. Në këto kushte manaxhimi efektiv i pagesës së kredisë bëhet një strategji kritike për t'u ndjekur. Gjithashtu duhet përmendur edhe fakti se vendi ynë karakterizohet nga një nivel i lartë informaliteti dhe probleme me regjistrin e pasurisë. Gjithashtu niveli i korrupsionit është i lartë, të gjitha këto i vështirësojnë institucioneve mikrofinanciare vlerësimin e riskut të kolateralit dhe mbledhjen e borxhit të keq .

### **3.7.2 Normat e interesit të mikrokreditimit**

Kostoja e servisimit të kredive është më e lartë se për bankat komerciale, sepse ngarkesat e administrimit për shuma të vogla janë proporcionalisht më të larta sesa për shuma më të mëdha parash. Institucionet duhet të ngarkojnë një normë interesi që do t'i mbulojë këto kosto dhe do të vazhdojë të japë hua për huamarrësit e ardhshëm. Normat e interesit të Grameen Bank janë zakonisht 20%, por në vende dhe institucione të tjera ato mund të jenë shumë më të

---

<sup>40</sup> F134-136:ECONOMICUS NR5/2010 . Revistë Shkencore e Fakultetit Ekonomik .

larta. Norma mesatare e interesit global është vlerësuar në 37%, me norma që arrijnë deri në 70% në disa tregje.<sup>41</sup>

---

<sup>41</sup> Për më shumë informata në linkun vijues : <http://nbrm.mk/ns-newsarticle-sto-treba-da-znaete-za-kolateralot-pri-barane-kredit-od-banka-al.nspx>

## KAPITULLI III: PROFILI I KURSIMORES MOZHNOSTI

### 4.1 Historiku

Kursimorja Mozhnosti është institucion financiar e cila në tregun financiar të Republikës së Maqedonisë ekziston më 16 vite të plota, fillesa e mikro kreditimit ne Mozhnosti daton prej vitit 1996. Duke marrë parasysh misionin dh vizionin, Kursimorja është e njohur në rolin e mbështetësit të njerëzve të cilët kanë nevojë për të fituar mbështetje financiare për idetë e tyre të mira afariste, besimin në iniciativën e lirë, kreativitetin individual dhe përgjegjësinë personale.

Kursimorja Mozhnosti është partner i rrjetit global mikro-financiar Opportunity International me seli në SHBA e cila gjendet në vendin e tretë prej gjithsej 42 institucioneve në botë. Radhitja është bërë sipas CAMEL sistemit për radhitje. Sot, Kursimorja ka rrjet afarist në mbarë territorin e shtetit: Shkup, (ekspozitura Aerodrom, QTQ dhe Leptokari), Kumanovë, Kavadar, Koçan, Veles, Strumicë, Tetovë, Kërçovë, Manastir, Strugë dhe Gostivar. Me 24 Maj Mozhnosti sëbashku me miqt e saj e festoi 21 vjetorin e ekzistimit. Ekzistojnë prej vitit 1996. Si institucion fillimet e saj i filloi me një tim të vogël, e tash ka arritur ne një numër prej 221 puntorë.

I përkrahin bizneset familjare, bujqësinë, prodhimtarinë dhe shërbimet. I përkrahin idetë e mira. Kursimorja është fokusuar për klientët mikro të cilët kanë kapacitet më të vogël, por që kanë potencial për rritje, e cila është në përputhje me misionin e saj dhe vizionin .Pra, fokusi është kryesisht në mikro grupet e synuara të konsumatorëve Bizneset (personave fizikë dhe juridikë) dhe fermerët. Angazhimi i Kursimores konsumatorët Banka e Kursimeve dhe SME-ve që zhvillimi i saj ka përjetuar në bashkëpunim me Bankën e Kursimeve, Bankës së Kursimeve, por gjithashtu pranon klientë të rinj të cilët nuk kishin përvojë të mëparshme. Për të diversifikuar portofolin aktiv dhe për të rritur bazën e klientëve, Shtëpia e Kursimeve është e fokusuar edhe në grupet e synuara Punonjësit e Rrogave, Studentët, Pensionistët dhe Stratus Ups.

Një pjesë e fokusit të familjes është për shkak të kufizimit të vërtetë për të punuar me klientët më të mëdhenj, sepse ato kanë nevoja më të sofistikuara. Duke krijuar marrëdhënie biznesi me sipërmarrës të mesëm dhe të vegjël, Shtëpia e Kursimeve ka përparësinë e mbajtjes së këtyre marrëdhënieve me të njëjtët sipërmarrës, aktiviteti i të cilëve më vonë është rritur ndjeshëm. Klientët e mikrofinancës zakonisht janë të vetëpunësuar në sipërmarrje të vogla familjare si dyqane të vogla pakice, shitje në rrugë, prodhim artizanal, furnizim të ushqimeve, etj. Në zonat rurale janë fermerët dhe sipërmarrjet e vogla me të ardhura të kufizuara, si prodhimi i ushqimeve, tregëtimi, etj.

Konsumatorët e mikro paguajnë një normë më të lartë për kreditë e tyre, por ata shpesh e pranojnë atë nëse kredia u lejon atyre të bëjnë një fitim. Klientët e tillë mikro logjikisht paguajnë kosto më të larta për shkak të faktit se ato janë të shtrenjta për t'u përpunuar dhe kanë kapacitet të ulët. Prandaj, kufijtë duhet të jenë më të larta për të mbuluar shpenzimet. Në thelb, kur bëhet fjalë për konsumatorët më të vegjël, çmimi është më i lartë. Prandaj, çmimet për klientët më të mëdhenj janë më të ulëta.

## 4.2 Strategjia e përdorur dhe misioni

### ■ Rrjeti i kursimores

Punojnë me mikro dhe shumë klientë të vegjël që kryejnë një aktivitet të caktuar (individë që janë të vetëpunësuar dhe kryejnë veprimtari si persona fizikë ose krijojnë kompanitë e tyre përmes të cilave kryejnë veprimtarinë), dmth. mikrokreditë dhe punojnë me persona fizikë të cilët realizojnë dhe mund të provojnë të ardhura të rregullta mujore, persona ose persona të lidhur me to.

*VIZIONI* i kursimores “Mozhnosti” “Vizioni ynë është botë më e mirë dhe njerëz më të lumtur. Ne besojmë në njeriun dhe aftësinë e tij të ndryshojë jetën me mundin e tij. Ne jemi dedikuar në luftën kundër varfërisë dhe marginalizimit social. Jemi të bindur që secili person meriton respektin dhe ndihmën”.

*MISIONI* i kursimores “Mozhnosti” , “Besojnë në lirinë e iniciativës, kreativitetin individual dhe përgjegjësinë personale. Misioni ynë është të sigurojnë mundësi – njerëzit në nevojë të fitojnë mbështetje për idetë e tyre të mira afariste. Ofrojmë qasje në kapital fillestar. Qëllimi është krijimi i vendeve të reja pune ndërsa metoda është – huadhënie të vogla për veprimtari të vogla. Presin – rezultatet e bizneseve të tyre të vogla të ndihmojnë vetes, familjes së tyre dhe komunitetit, me çfarë institucioni ynë do të bëhet subjekt i respektuar në tregun financiar”.

Qëllimi i shfrytëyimit të produkteve kreditore për klientët e vegjël :

- **Asetet rrjedhëse dhe kapitali qarkullues;**
- **Blerja e aseteve të materialeve (mjetet e transportit, pajisjet ose ndërtesa);**
- **Kreditë për nevojat personale ose familjare të personit që po bën biznes;**

### 4.3 Miratimi i kredive

Të gjitha ekspozimet ndaj klientëve që u përkasin kategorive të bankave dhe klientëve të vegjël dhe të mesëm përdoren nga bordet e kreditit. Komiteti i Kredive është një organ i Bankës së Kursimeve e cila përbëhet nga të paktën 3 anëtarë të emëruar vetëm partnerë në përputhje me rregulloret e brendshme të Bankës së Kursimeve. Shtëpia e kursimeve mund të ketë një ose më shumë borde të kreditit. Bordet e kredive marrin vendime, konkluzione dhe rekomandime. Komisionet e Kreditit vendosin të miratojnë huatë sipas kërkesave të huasë nga huamarrësit brenda kufijve të miratuar nga rregulloret aktuale dhe produktet e Shtëpisë së Kursimeve.

Metoda e vendimmarrjes së bordeve të kreditit në lidhje me një kërkesë që devijon nga produktet e Kursimeve është e rregullt në aktet e brendshme të Shtëpisë së Kursimeve. Të gjitha zonat e miratimit të kredisë në Shtëpinë e Kursimeve përcaktohen në Vendimet mbi formimin e bordeve të kredive të miratuara nga aksionarët e vetëm të Shtëpisë së Kursimeve. Për të siguruar një proces të shpejtë dhe efikas të miratimit të kredisë. Aksionari i vetëm shqyrton dhe miraton politikat dhe procedurat për bordet e kredive që funksionojnë në një parim të

centralizuar dhe të decentralizuar. Komisionet e kreditit të tretë deri në nivelin e pestë janë komisionet e kreditit që veprojnë nën një parim të decentralizuar.

Komisionet e kreditit të tretë deri në nivelin e pestë janë kreditorë që operojnë në mënyrë të centralizuar. Partneri i vetëm miraton të gjitha ekspozimet kreditore për një aksionar apo anëtar me pjesëmarrje të kualifikuar në Bankën e Kursimeve dhe personat e saj në lidhje me një person me të drejta dhe përgjegjësi të veçanta dhe personave të lidhur.

❖ **Politika e çmimeve**

❖ **Çmimi i produkteve të kredisë të përdorura nga klientët e Bankës së Kursimeve, pas shpenzimeve katagorii duhet të llogaritet si pjesë e çmimit nga norma e interesit ose crumbs tjera**

❖ **Shpenzimet për burimin e fondeve**

❖ **Shpenzimet operative**

Kostot për mbulimin e humbjes për shkak të mos pagesës së atij lloji të produkteve të huasë .Përveç mbulimit të kostove, çmimi i produkteve është i rregulluar në metodologjinë për miratimin e normave aktive të interesit të Shtëpisë së Kursimeve Moznosti. Formimi i çmimit të produkteve të kredisë rregullohet në Metodologjinë për miratimin e normave aktive të interesit të Moznosti . Shtëpia e Kursimeve në çmimet, gjithmonë vlerëson me kujdes rrezikun e kredisë që është karakteristike e çmimeve.

Banka e Kursimeve me klientët e kreditit apo projekte që kanë nivel mbi-mesatar të lartë të rrezikut, madje edhe në rastet kur mund të vendos normen e interesit dhe tarifatat më të larta se ato të përcaktuara nga brenda .Interesi llogaritet çdo vit me një metodë proporcionale , obligimet e pagesës bien në përfundim në fund të periudhës për të cilën është llogaritur Norma e interesit është fikse. Normat e interesit dhe kushtet e tjera të çmimeve përcaktohen në nivelin e një produkti kredie. Shtëpia e kursimit, përveç interesit, ngarkon ose mund të ngarkojë kosto dhe komisione të tjera, vlera e të cilave dhe mënyra e llogaritjes dhe grumbullimit gjithashtu përcaktohet në nivelin e një produkti kredie. Shtëpia e kursimit ngarkon një shpenzim manipulues.

Shpenzimet manipulative përfaqësojnë koston e përpunimit të kërkesave. Është llogaritur si përqindje e shumës së kredisë që i nënshtrohet aprovimit, dmth pagesës. Shpenzimet manipuluese janë akuzuar vetëm një herë në shpërndarjen e fondeve nga huaja zgjatur për klientin. Te njëjtit nuk mund të ndryshohen gjatë shlyerjes së kredisë. Banka e Kursimeve ngarkon një komision mujor për tërheqjen e kredisë (MHP) dhe është fikse. Shtëpia e Kursimeve vendos dy lloje të kolateralit mujor - MPU 1 dhe MPU 2.

- MPU 1 llogaritet si përqindje e shumës së kredisë që jepet. Paraqitur për mbledhjen mujore, në pjesë të barabarta (shuma e barabartë mujore) të shpërndara në afatin e caktuar ;
- MPU 2 llogaritet si përqindje e pjesës së mbetur të borxhit kryesor për periudhën në të cilën ajo lidhet. Ai përshtatet në baza mujore, ku shuma e tarifës mujore të menaxhimit ndryshon çdo muaj.

Vlera specifike e të gjitha elementeve kostoja e produkteve të kredisë (norma e interesit, të trajtimit që, tarifë mujore menaxhimit) është përcaktuar në normat e interesit .

#### **4.4 Mikrokreditimi te kursimorja „Mozhnosti”**

Mikro-kreditimi përfshin huadhënien e klientëve mikro dhe shumë të vegjël. Si klientët mikro dhe shumë të vegjël përcaktojnë klientët, individët dhe personat juridikë, të cilët kryejnë një aktivitet të caktuar nga i cili fitojnë të ardhura. Kursimorja ju ofron kredi klientëve shumë të vegjël si p.sh - tregtarëve , shërbimin, artizanateve, prodhimtarët, bujqësëve, me turizmin apo aktivitete të tjera që ofrojnë punë dhe të ardhura për veten dhe anëtarët e familjes së tyre .

**Tiparet e përbashkëta të klientëve mikro dhe shumë të vegjël janë :**

- Ata kanë shumë pak kapital, shprehur përmes parave, pajisjeve të punës dhe ndërtesa (konsumatorët Micro në 50.000 euro, dhe shumë konsumatorë të vegjël në 150,000 në denarë) ;



- Kryesisht fillestar në terren, apo ekzistojnë në treg nuk është më shumë se 5 vjet ;
- Ata kanë një numër shumë të vogël të të punësuarve, më shumë se 10 njerëz, me shumica e aktiviteteve të kryera nga anëtarët e familjes të lartë (bizneset familjare)të ardhura relativisht të ulëta vjetore në klientët mikro zakonisht gjenerojnë të ardhura vjetore deri 1500000 denarë, dhe shumë konsumatorë të vogël për të 1500000 denarë të ardhura vjetore ;
- Kryesisht të ardhurat dhe shpenzimet e biznesit dhe familjes nuk janë krejtësisht të dallueshme ;
- Më shpesh nuk kanë ose kenë një histori të kufizuar krediti ;
- Pronari dhe menaxheri janë të përqendruar në një person ;
- Ata jetojnë dhe punojnë në zonat urbane dhe rurale;
- Në shumicën e rasteve punojnë në tregjet lokale, kërkojnë produkte të thjeshta bankare dhe shërbime si (kreditë dhe operacionet e pagesave) ;

#### 4.5 Vlerësimi i rrezikut të kredisë në kursimoren „Mozhnosti “

Në vlerësimin e rrezikut të kredisë për huadhënie ndaj individëve dhe personave juridikë, Shtëpia e Kursimit përdor tre komponentë:

- (1) gjasat që huamarrësi të mos përmbushë siç duhet detyrimet e tij (fluksi i pritshëm i parave);
- (2) një vlerësim të humbjes në kohën e mospagimit në kryerjen e detyrimeve;
- (3) vlerën dhe cilësinë e kolateralit për ekspozimin.

(1) Shtëpia e Kursimit vlerëson mundësinë e prapambetjes nga klientët individualë duke përdorur mjete të brendshme vlerësimi të përshtatura për kategori të ndryshme të klientëve. Ato janë zhvilluar nga brenda dhe kombinojnë analizën statistikore dhe vlerësimin e komitetit të kredisë së zyrës dhe degës. Procesi i përgatitjes së aplikimit të kredisë, si dhe procesi i miratimit të kredisë :

- Analiza e kredisë kryhet për të lejuar vlerësimin e rrezikut të kredisë. Ai përfshin një analizë të parametrave themelore të huamarrësit, një analizë e pasqyrat zyrtare financiare, analiza e fluksit të parave, parashikimet e flukseve të ardhshme të parave dhe përbërësi i zhvillimit të biznesit, tërheqja e degëve dhe cilësia e kolateralit.

(2) Humbjet në kohën e mos përmbushjes së detyrimeve paraqesin pritjet për nivelin e humbjes së pretendimeve të papaguara, do e analizojmë nëpërmjet politikës së kontabilitetit :

- Renditja e brendshme në Shtëpinë e Kursimeve ;
- Klasifikimi në kategorinë e duhur të rrezikut të kredisë. Sipas Vendimi i Menaxhimit të Riskut të Kredisë, Shtëpia e Kursimeve klasifikon dhe vendos zhvlerësimin për të gjitha ekspozimet e kreditit në baza individuale. Klasifikimi në kategorinë e duhur të rrezikut bëhet në bazë të besueshmërinë e klientit, rregullsinë e shlyerjes së detyrimeve dhe cilësia e kolateralit. Baza e klasifikimit të klientit / ekspozimit është një analizë e plotë e performanca dhe disiplina e klientit - vlerësimi i aftësisë ekonomike, aftësisë paguese dhe aftësisë për të gjeneruar prurje. Në të njëjtën kohë, një analizë e tillë e të dhënave nga periudhat e kontabilitetit aktual dhe historik lejojnë vlerësimin e likuiditetit dhe përfitimin e biznesit, përcaktimin e aftësisë së huamarrjes, vlerësimin e stabilitetit financiar të ardhshëm të klientit dhe reflektimin e tij si dhe fluksi i saj i ardhshëm i parave. Matrica M1 për Ekspozimin / Klasifikimin e Klientit është në të vërtetë një proces sublimimi i performancës së analizuar të klientit dhe disiplina financiare e tij. Në të njëjtën kohë, Matrica M1 është një instrument për analizimin e klientëve dhe kategorizimin që është bazuar në treguesit e marrë, në një profil të duhur rreziku. Matrica M1 është një grup funksional i tre proceseve të ndërlidhura:

**Procesi 1-** Vlerësoni aftësinë e kredisë dhe rregullsinë në shlyerjen e borxheve për klientët:

- Shuma e kapitalit, rezervat, prona e klientit dhe aftësia për të bërë hyrje të parave të ardhshme;
- Vlerësimi nëse qëllimi kontraktues i huasë / ekspozimit shkakton një fluks të përputhur me metodën e rënë dakord të shlyerjes së detyrimeve;
- Perspektiva e klientit dhe biznesit dhe identifikimi i tregut aktiv për veprimtarinë e klientit;
- Karakteri i klientit - statusi i tij dhe karakteristikat ekonomike, cilësia dhe ekspertiza e organeve menaxhuese dhe cilësia e programit për të cilin kërkohet mbështetje financiare;
- Ndikimet e klientëve në lidhje me klientin në vlefshmërinë e tij të kredisë;
- Treguesit e paralajmërimit të hershëm për rrezikun e kredisë së klientit;
- Grupi i synuar dhe përkatësia e segmentit;
- Ekspozimi ndaj klientëve në Sistemin Bankar të Republikës së Maqedonisë;
- Vonesa e klientit në përmbushjen e detyrimeve në sistemin bankar të Republikës së Maqedonisë;
- Historiku i kredive që ka pasur dhe ka klienti / ekspozimi ndaj Bankës së Kursimeve - shpeshtësia e shlyerjes së detyrimeve.

**Procesi 2** - Vlerësimi i kushteve dhe kriterëve specifike që ndikojnë në kategorinë e rrezikut të kredisë.

- Historia e Vonesës së Klientit;

- Kërkesë për klasifikim funksional, jo funksional, i paditur - kërkesë për klasifikim;
- Arkëtimet e ristrukturuara; - Falimentimi / likuidimi;
- Garancia e depozitave - kolateral i klasit të parë.

### **Procesi 3** - Zbritja e fluksit të parave të pritura dhe përcaktimi i zhvlerësimit

Pas klasifikimit duke përdorur matricën M1, procesi i llogaritjes dhe përcaktimit të zhvlerësimit për secilën ekspozim ndjek ndryshimin midis vlerës kontabël të arkëtimeve / ekspozimit dhe vlerës së tyre aktuale të përcaktuar duke zbritur flukset e ardhshme të parave të gatshme në ato të arkëtueshme, duke përdorur metodën efektive të normës së interesit. Norma e interesit (e përcaktuar në përputhje me metodologjinë për llogaritjen dhe vlerësimin e sendeve të kontabilitetit dhe përgatitjen e pasqyrave financiare), e përcaktuar në bazë të kushteve kontraktuale .

3) Kur klasifikon ekspozimet, Shtëpia e Kursimeve merr parasysh kolateralin si një element vlerësimi vetëm në rastin e shkallës së pare instrumentet e kolateralit dhe në rastet e përcaktuara të ekspozimit kategorizuar në grupe rreziku D ose E për të cilat Shtëpia e Kursimeve pret që të rikuperohet aktivizimi i sigurisë. Për ekspozimet e kategorisë së rrezikut R&D për të cilat Shtëpia e Kursimeve ka ndërtuar pritja e rikuperimit të ekspozimit përmes aktivizimit të kolateralit, është procesi i përcaktimit të vlerës aktuale të fluksit të parave të ardhshme që përfshijnë vlerën e kolateralit si fluksi i pritshëm i parasë nga shitja e saj, megjithë prurjet e pritura të shlyerjes së detyrimeve nga ekspozimi në përputhje me kriteret e Vendimit të Menaxhimit të Riskut të Kredisë.

Ekspozimi ndaj një personi dhe personave të lidhur me të nuk duhet të tejkalojë 10% të fondeve të veta të Kursimeve .Ekspozimi ndaj një aksionari, domethënë një partner me pjesëmarrje të kualifikuar në Shtëpinë e Kursimeve dhe personat e lidhur me të, nuk duhet të tejkalojë 5% të fondeve të veta të Kursimeve.Ekspozimi për një person me të drejta dhe përgjegjësi të veçanta dhe personave të lidhur nuk mund të kalojë 3% të fondeve të veta të

Bankës së Kursimeve. Ekspozimi ndaj bankave dhe shtëpive të kursimit nuk duhet të tejkalojë 30% të fondeve të veta të Kursimeve. Ekspozimi i përgjithshëm për persona aksionarit, përkatësisht anëtar me pjesëmarrje të kualifikuar në Bankën e Kursimeve dhe subjektet e saj lidhur dhe të personave me të drejta dhe përgjegjësi të veçanta dhe personave të lidhur nuk mund të tejkalojë 65% të fondeve të veta të Bankës së Kursimeve .






#### 4.6 Kontrolli i kufijve të ekspozimit dhe politikave të mbrotjes së rrezikut

Banka e Kursimit administron dhe kontrollon përqendrimin e rrezikut të kredisë për baza individuale dhe grupore, si dhe sipas sektorëve. Banka e Kursimit strukturon nivelin e rrezikut të kredisë të ndërmarrë duke analizuar sasinë e rrezikut të pranuar nga huamarrësi, ose grupi i huamarrësve, dhe nga segmentet gjeografike dhe sektoriale. Rreziqe të tilla monitorohen vazhdimisht në bazë të bazave të të dhënave të brendshme dhe i nënshtrohen analizës ditore.

##### (a) Siguria

Kolaterali konsiderohet gjithmonë si një faktor dytësor në vlerësimin e vlerës së kredisë. Vetë kolaterali, pa aftësinë për të gjeneruar fluks parash, nuk është i mjaftueshëm për të justifikuar miratimin e kredisë. Llojet themelore të kolateralit për sigurimin e kredive janë:

##### (1) Për personat juridikë

-  **Depozitat nga themeluesi - persona fizikë ;**
-  **Pasuri të paluajtshme;**
-  **Pasuri lëvizëse (pajisje, automjete motorike);**
-  **Pajisje;**
-  **Të arkëtueshme;**

- ✚ **Garancitë (garancitë bankare dhe garancitë nga personat juridikë);**
- ✚ **Fatura e këmbimit;**

(2) Për persona fizik

- ✚ **Depozitat;**
- ✚ **Pasuri lëvizëse (pajisje, automjete motorike);**
- ✚ **Pasuri të paluajtshme;**
- ✚ **Garancitë (garancitë nga personat juridikë);**
- ✚ **Fatura e këmbimit;**

#### **4.7 Garancitë për kreditë mikro dhe shumë klientë të vegjël**

Garancitë për kredi miratimi klientët mikro janë të përcaktuara në bazë të tipareve të këtij lloji të klientëve dhe në bazë të ekspozimit organike për këtë lloj të klientëve .Siç garanci të pranueshme të përcaktojë .

Fatura e shkëmbimit dhe faturën e këmbimit nga aplikanti dhe garantuesi , ndalimi administrativ i garantuesve, firmosjen e shkëmbimit në formën e një akti publik noterial nga kërkuesi dhe garantuesit, Marrëveshja e huasë.

Përveç punës me mikro dhe klientë të vegjël , politika e kredisë në Kursimoren gjithashtu siguron kreditimin e klientëve të vegjël dhe të mesëm. Pas zhvillimit të mikro dhe klientëve të vogël, e cila u rrit në një konsumatorëve të vogla apo të mesme ekzistuese dhe identifikimin e nevojave të tyre për ekspozimet e mëdha të kreditit, Banka e Kursimeve me politikën e kreditit kërkon kreditimin e tyre, në mënyrë që ata të qëndrojnë si klientë të Bankës së Kursimeve.

Përveç konsumatorët ekzistues të cilët kanë zhvilluar punën e tyre, tregu është aktiv dhe klientëve që i përkasin kategorisë së konsumatorëve vogla dhe të mesme, dhe që kanë nevojë për kredi shtesë për ngarkesën e punës së tyre .

Tiparet e përbashkëta të klientëve të mesëm janë :


- Ata kanë kapital të afërm të ulët shprehur përmes parave, pajisjet e punës dhe ndërtesa (Konsumatorët e vogël për 300.000 den, dhe konsumatori mesatar më shumë se 300,000 euro në kundërvlerë me denarë) ;
- Më shpesh ekzistojnë në treg për më shumë se 5 vjet;
- Klientët e vegjël kanë nga 10 deri në 50 të punësuar, ndërsa punonjësit e mesëm kanë mbi 50 punonjës (në aktivitete me intensitet të lartë ky numër mund të jetë më i madh në klientët e vegjël dhe të mesëm) ;
- Të ardhurat vjetore në mes të konsumatorëve të vogla zakonisht shkon deri në 50.000.000 denarë, ndërsa në klientë të mesme përmes deanri 50.000.000;
- Ata kryejnë aktivitetin formalisht (me dokumentet dhe lejet e nevojshme);

Në rastin e klientëve të vegjël është më karakteristike që të ardhurat dhe shpenzimet e biznesit dhe të familjes nuk janë plotësisht të dallueshme, ndërkohë që mes klientëve të mesëm pronarët e veprimtarisë dallohen financiarisht nga personi juridik. Të dy klientët e vegjël dhe të mesëm kanë një histori të rëndësishme krediti .Kushtet për tu kredituar klientët e vegjël dhe mikro kanë karakteristikat e mëposhtme : ekspozimit më të madh të kredisë, kolaterali është shpesh një peng të pasurisë, çmimi kushte të favorshme të çmimeve, një vëllim më të madh të dokumentacionit të kërkuar.Shtëpia e Kursimeve ka një metodologji të përmirësuar për të punuar me klientët e vegjël dhe të mesëm.


Metodologjia përfshin mjete të tjera për të analizuar bilancin dhe pasqyrën e të ardhurave, analiza e rrjedhës së parasë, analizë të planit dhe programit të klientit, të përshtatshme për njësinë ekonomike procedurës, struktura organizative e personit juridik, veprimtaria në të cilën ajo është procedura aktive e duhur për të punuar me këta klientë , me ç'rast pjesa e të detyruarve pjesë e procedurës i viziton klientët në vendin ku bëjnë biznesin (lokalet afariste, depot, sallat etj)bime bankare (letrat e kreditit, garanci, etj) .

Produktet e kreditit për klientët mikro dhe shumë të vegjël janë të destinuara për:

- Asetet rrjedhëse dhe kapitali qarkullues
- Blerja e aseteve të prekshme (mjetet e transportit, pajisjet ose pajisjet)
- Kredi për nevoja personale ose familjare të personave me përgjegjësi të veçantë dhe persona juridikë .







Activata Winda

### 3.8. Produktet kreditore



## 4.8 Risku nga interesi

Për klientin edhe shlyerjen e ardhshme të detyrimeve të kredisë është e dobishme llogaritja e shlyerjeve (plani i amortizimit) dhe dinamika e kësteve për shlyerje, në të cilën janë dhënë kryegjëja dhe interesi. Një segment i veçantë i informacioneve parakontraktuese dedikohet për shpenzimet për kredi. Në këtë pjesë, duhet të shënohen lloji dhe lartësia e normës së interesit e cila do të aplikohet (e shprehur në % në bazë vjetore), gjegjësisht të gjithë normat e interesit, nëse aplikohen më shumë norma të interesit në periudha të ndryshme të kohëzgjatjes së marrëveshjes për kredi, si dhe shpenzimet tjera të cilat paguhet për miratimin e kredisë dhe dalin nga marrëveshja për kredi.

Klienti duhet t'i kushtojë vëmendje të veçantë llojit të normës së interesit që do të aplikohet, e cila mund të jetë fikse ose e ndryshueshme (variabile). Norma e ndryshueshme e interesit përbëhet prej një indeksi të pavarur të tregut ose normës referente dhe margjinës së interesit. Norma e ndryshueshme e interesit mund të ndryshojë varësisht zhvillimeve në indeksin e tregut ose normën referente të interesit, të cilat duhet të vendosen nga ana e bankës, bashkë me periudhat, kushtet dhe procedurën për ndryshim. Në vendin tonë, bankat si bazë për përcaktimin e lartësisë së normave të kontraktuara të interesit për kredi në valutë vendase zakonisht e përdorin normën e interesit nga instrumenti themelor i operacioneve në tregun e hapur (ankandet e bonove të bankës qendrore) të Bankës Popullore (normë referente) ose të ashtuquajturës norma kombëtare e interesit që paraqet normë të interesit të depozitave në denarë pa klauzolë valutore, të cilave më vonë u shtohet margjina e interesit.

Margjina e interesit ndryshon nga banka në bankë dhe mund të jetë e ndryshme për klientë të ndryshëm në pajtim me bonitetin e tyre. Për kreditë e përcaktuar dhe shprehur në valutë të huaj, bankat shpesh si normë referente të interesit aplikojnë normën disamujore të EURIBOR (shpesh EURIBOR-in 6-mujorë - normë të interesit ndërbankar të tregut në eurozonë). Gjatë ndryshimeve në normat e dhëna të interesit, bankat, në mënyrë të përshtatshme, në kuadër të intervaleve paraprakisht të përcaktuara do të ndryshojnë normën e ndryshueshme të interesit të kredisë.

Ndryshimi i normës së interesit është sigurisht një informacion i rëndësishëm që klienti duhet ta dijë paraprakisht (lëvizja e normës referente të interesit mund të kushtëzojë rritje ose ulje të normës së interesit të kredisë), me ç'rast duhet të theksohet nëse banka do ta informojë klientin për ndryshimin e normës së interesit ose ndryshimet do të bëhen automatikisht, në pajtim me lëvizjen e normave referente të interesit.

Nëse ekziston qasje tjetër gjatë përcaktimit të normës së ndryshueshme të interesit, banka gjithashtu është detyruar të tregojë. Kjo posaçërisht duhet të bëhet në raste të aplikimit të të ashtuquajturës normë të rregullueshme të interesit ku bankat në mënyrë të njëanshme vendosin për ndryshimin e normës së interesit, edhe pse bankat gradualisht e ulin përdorimin e kësaj qasjeje, me rekomandim të Bankës Popullore.

Norma e totalit të shpenzimeve për kredi konsumatore të cilën e miratojnë bankat në praktikë është disa pikë përqindjeje mbi normën e kontraktuar të interesit të përcaktuar në marrëveshjen për kredi.

#### 4.8.1 Analiza Financiare

Në analizën financiare të kursimores Mozhnosti kemi analizuar dy vite , vitin 2018 dhe 2017 se si ka ecur bilanci i kursimores Mozhnosti Doo nga të dhënat zyrtare të publikuara prej llogarive përfundimtare të reviduara nga shtëpia e revizionit Moore Stephens Shkup .

**Tabela 7** : Analiza Financiare / Bilanci i suksesit Mozhnosti

| <b>Bilanci i suksesit –Kursimorja Mozhnosti Doo</b>     |                   |                   |                   |
|---|-------------------|-------------------|-------------------|
| <b>Treguesit financiarë</b>                             | <b>31.12.2019</b> | <b>31.12.2018</b> | <b>31.12.2017</b> |
| <b>Neto të hyra nga interesi</b>                        | <b>189.863</b>    | <b>153.942</b>    | <b>146.359</b>    |
| <b>Neto të hyra nga provizionet</b>                     | <b>1.845</b>      | <b>852</b>        | <b>140</b>        |
| <b>Neto të hyra nga dallimet në kurs dhe të hyra të</b> | <b>15.736</b>     | <b>17.323</b>     | <b>18.208</b>     |

|   |        |        |        |
|---|--------|--------|--------|
| tjera                                   |        |        |        |
| Shpenzime për punëtorët                 | 88.058 | 85.529 | 83.714 |
| Amortizim                               | 10.095 | 7.941  | 6.339  |
| Të dalat e tjera                        | 45.455 | 58.580 | 60.815 |
| Fitimi(humbja) para tatimit             | 14.364 | 19.779 | 16.847 |
| Tatimi i fitimit                        | 2.750  | 3.222  | 2.762  |
| Fitimi(humbja) neto per vitin financiar | 11.614 | 16.557 | 14.085 |

Burimi : Puna e vetë autorit bazuar në të dhënat e Mozhnosti

**Tabela 8** : Analiza Financiare / Bilanci i gjendjes Mozhnosti

| <b>Bilanci i gjendjes –Kursimorja Mozhnosti Doo</b> |                   |                   |                   |
|---|-------------------|-------------------|-------------------|
| <b>Treguesit financiarë</b>                         | <b>31.12.2019</b> | <b>31.12.2018</b> | <b>31.12.2017</b> |
| <b>Aktiva</b>                                       | <b>1.820.299</b>  | <b>1.749.520</b>  | <b>1.686.340</b>  |
| <b>Obligimet</b>                                    | <b>1.389.756</b>  | <b>1.317.345</b>  | <b>1.259.454</b>  |
| <b>Kapitali</b>                                     | <b>300.152</b>    | <b>300.152</b>    | <b>300.152</b>    |
| <b>Rezerva të tjera</b>                             | <b>118.777</b>    | <b>115.466</b>    | <b>112.649</b>    |
| <b>Fitimi i akumuluar</b>                           | <b>11.614</b>     | <b>16.557</b>     | <b>14.085</b>     |
| <b>Gjithsej kapitali dhe rezervat</b>               | <b>430.543</b>    | <b>432.175</b>    | <b>426.886</b>    |
| <b>Gjithsej kapitali,rezervat dhe obligimet</b>     | <b>1.820.299</b>  | <b>1.749.520</b>  | <b>1.686.340</b>  |

Burimi : Puna e vetë autorit bazuar në të dhënat e Mozhnosti

Nga të bilanset përfundimtare të Kursimores Mozhnosti Doo për vitet 2018 dhe 2017 mund të vërejmë këto rezultate financiare të kursimores:

- Në vitin 2018 kursimorja ka realizuar rritje të të hyrave neto për 4.5% në krahasim me vitin paraprak(2017) . Në strukturën e të hyrave totale pjesëmarrje më të madhe kanë të hyrat nga interesi që paraqesin 89.4% të të hyrave totale.

- Shpenzimet në vitin 2018 janë zvogëluar për 0.78% në krahasim me shpenzimet e kursimores në vitin paraprak. Në strukturën e shpenzimeve pjesëmarrje më të madhe kanë shpenzimet operative të kursimores që paraqesin 61.06% të shpenzimeve totale.
- Derisa obligimet e kursimores shënojnë rritje në vitin 2018 krahasuar me vitin paraprak prej 4.6%.

Në vitin 2018 kursimorja Mozhnosti ka realizuar rritje të fitimit neto prej 17.55%.

Kursimorja Mozhnosti mban një nivel adekuat të mjeteve likuide duke u përmbajtur masave rregullatore të BPRMV si dhe limiteve interne për koeficientët e likuiditetit.

Në strukturën e kapitalit dhe rezervave , kapitali paraqet 69.45%. Fondet rezerve kanë pjesëmarrje prej 26.72% ndërsa 3.83% pjesëmarrje ka neto fitimi për vitin 2018 që duhet të shpërndahet.

- **Rreziku kreditorë në kursimoren Mozhnosti**

Në vitin 2018 kursimorja Mozhnosti hasi në rritje të ekspozimit kreditorë ndaj kategorive që paraqesin rrezik më të madh(të klasifikuar në kategoritë C;D dhe E) në raport me vitin 2017 . Derisa në vitin 2017 ekspozimi kreditorë nga këto kategori ishte 48.775mijë denarë në vitin 2018 ekspozitmi kreditorë është 54.191mijë denarë që paraqet një rritje prej 11.10% .

Gjithashtu në vitin 2018 hasim rritje të kredive të këqija në portfolion totale të kredive të kursimores Moznosti . Niveli i kredive të këqija në vitin 2017 ishte 2.96% ndërsa në vitin 2018 kreditë e këqija kanë pjesëmarrje në portfolion totale të kredive në nivel 3.25%.

Në vitin 2018 ekspozimi total në kursimoren Moznosti është 1.549.289mijë denarë. Nga portfolio totale e kredive te subjektet juridike jofinansiare janë plasuar 10.55% e kredive derisa 89.45% janë plasuar te klientët e tjerë( tregëtarë individual dhe persona fizik).

Në portfolion totale të kredive të kursimores Moznosti në bazë të kategorive kreditet kanë strukturën si në vijim : në kategorinë A janë të klasifikuar 91.09% ,në kategorinë B janë të

klasifikuar 5.41% , në kategorinë V janë të klasifikuar 0.78%, në kategorinë G janë 0.30% dhe në kategorinë D janë të klasifikuar 2.42%.<sup>42</sup>

---

<sup>42</sup> [www.mozhnosti.com.mk](http://www.mozhnosti.com.mk)

## KAPITULLI IV: METODOLOGJIA

### 5.1 Hulumtimi

Për të realizuar qëllimin kryesor të këtij hulumtimi duhet t'i kryejmë disa detyra:

- 1).Të hulumtojmë dhe grumbullojmë literaturën e analizës kreditore;
- 2).Të analizojmë përfaqësimin e mikro bizneseve gjatë miratimit të kredive ;
- 3).Të përpilojmë anketë si instrument hulumtues, përmes të cilës do të grumbullojmë informacion për mënyrën e udhëheqjes të sistemit bankar me theks të veçantë analiza kreditore;
- 4).T'i analizojmë të dhënat hulumtuuese;
- 5).T'i interpretojmë rezultatet e hulumtuara;
- 6). Nxjerjen e konkluzioneve dhe rekomandimeve;

Pjesa teorike ka material të mjaftueshëm për të shfletuar në të gjitha gjuhët prandaj është më e lehtë për të siguruar informacionet e nevojshme. Ndërsa tek pjesa empirike kam hasur vështirësi , veçanërisht pjesën e diskutuar për sistemin e analizës së mikrokredive a i bane vendimet efikase dhe eficiente , thjeshtësimi byrokratik , por duhet theksuar se gjatë punimit të temës kemi hasur në mungesë të të dhënave të nevojshme për trajtim të cilat të dhëna nuk i dispononte Banka Qendrore nuk kishte të ndarë mikrokreditet, bëri që kjo procedurë të zgjaste më tepër, prandaj edhe hulumtimi është realizuar me anketë tek klientët e bankave dhe punojnësve në bankë . Që ti përgjigjemi hipotezave kemi pregaditur disa lloj të anketave . Anketimi është realizuar për 2 muaj , në tre komuna, në nivel rajonal.

### 5.2 Grumbullimi

Gjatë këtij hulumtimi kemi përdorur të dhëna nga burime primare dhe burime sekondare, përfshirë këtu artikuj përkatës të vlefshëm online dhe libra në të cilat përfshihet banakat , sistemi bankat gjatë analizës së kredive si dhe të dhëna të marra nga pyetësi. Të

dhënat e marra nga pyetësi janë realizuar në Rajonin e Pollogut , Shkup , Gostivar , në gjithsej 65 të anketuar si klientë të bankave dhe 50 të anketuar punojnës banke ( të cilët udhëheqin biznese mikro ) apo referent kreditor ( analistë kreditor ).

Përfaqësuesit e këtyre bizneseve dhe punojnësit të bankave , pavarësisht pozitës së janë shprehur të gatshëm që të bashkëpunojnë me qëllim arritjen e rezultateve nga ky pyetësor. Të dhënat e marra nga librat dhe artikujt e përmendur janë të analizuar dhe të zgjedhur për trajtim. Gjithashtu, mes hipotezave dhe teorive ekziston një lidhje për ta bërë sa më të qartë mesazhin e temës. Informatat e dhëna në formë rezultati nga pyetësi janë të analizuar dhe të përshkruara në përputhje me pjesën teorike të punimit, gjithmonë në përpjekje për të ecur një hap më tej në lidhje me informacionin për dhënien e kredive si dhe kredibiliteti i mikrokredivë .

### 5.3 Rrezultatet

Burime të të dhënave për analizën empirike në këtë studim janë raportet e ndryshme nga Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Enti Statistikor i Republikës së Maqedonisë.

Tabela e mëposhtme ilustron të dhënat për numrin e subjekteve aktive ne Republikën e Maqedonisë së Veriut :

**Tabela 9** : Numri total i subjekteve( sipermarrjeve) sipas numrit te punetoreve

| Numri i punëtorëve | 0-9    | 10-19 | 50-249 | 250+ | Totali |
|--------------------|--------|-------|--------|------|--------|
| Numri i subjekteve | 68.830 | 2.237 | 1.404  | 232  | 75.914 |

Burimi : Puna e vetë autorit bazuar në të dhënat e Entit statistikor

Sipas Entit statistikor të Republikës së Maqedonisë së Veriut me 31.12.2019 në vend janë aktive gjithsej 75.914 subjekte juridike-sipermarrje private. Nga të cilat 90,7% janë mikro-



ndermarrje që punesojnë deri në 9 punetore. Ndermarrje të vogla dhe të mesme përbejne 9% të numrit total të ndermarrjeve dhe 0.3% përbejne firmat e medha me mbi 250 punetore.

Nga keto të dhena mund të shohim rëndesine e zhvillimit të mikrokreditimit në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe rolin që mikrokredite e kanë në sistemin bankar të vendit. Pikerisht për shkak të numrit të madh të ndermarrjeve mikro që operojne në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe numrit të konsiderueshem të kerkesava për kredi nga institucionet e ndryshme në vend kanë bërë që edhe këto të fundit ti kushtojnë rëndesi të vecante sektorit të mikrokreditimit. Gjate këtyre pesë viteve të fundit që anazilojme në këte teme hasim në ndryshime të vazhdueshme në proceduren e mikrokreditimit gjegjësisht në proceduren e procesimit, miratimit dhe monitoringut të mikrokredive nga institucionet financiare.

***Hipoteza kryesore (H1):*** Sistemi i analizës së mikrokreditimeve i bënë vendimet më efikase dhe eficiente .

***Hipoteza ndihmëse (H1.1):*** Thjeshtësimet byrokratike në këtë sistem mund të rritin efikasitetin dhe eficiencën

Në Republikën e Maqedonisë së Veriut në pesë vitet e fundit hasim në nje rritje konstante të plasmanit te kredive tek ndermarrjet me përjashtim të vitit 2016 kur hasim në nje ulje nga viti paraprak. Sipas të dhënave të Bankes Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut me 31.12.2019 totali i ekspozimit kreditor nga subjektet juridike-jo financiare në vend është 217.671.000 denarë që paraqet një rritje prej 4.1% krahasuar me gjendjen e datës 31.12.2018. Rritje konstante hasim gjithashtu në vitet paraprake duke perjashtuar vitin 2016 kur realisht është evidentuar ulje e normës se ekspozimit kreditor të ndermarrjeve ne vend.

Meqë nga institucionet në vend sikur Enti statistikore i Republikës se Maqedonisë së Veriut dhe Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut nuk ka të dhena precize për formen dhe madhesinë e subjekteve që janë perdorues të kredive dhe llojit të kredive që perdorin si reference kryesore të krahasimit të trendeve për kredi-marrje do ta shqyrtojmë tabelen 11 me të dhëna totale të shumës së kredive të miratuara për ndermarjet jo financiare në vend dhe ndermarrjet me pronare të vetem.

**Tabela 10** : Ekpozimi i kredive

| Ekpozimi I kredive ( në milionë denar )        | 31.12.2015     | 31.12.2016     | 31.12.2017     | 31.12.2018     | 31.12.2019     |
|--|----------------|----------------|----------------|----------------|----------------|
|  | Totali         | Totali         | Totali         | Totali         | Totali         |
| Ndërmarrjet jo-financiare dhe klientët e tjerë | 198,476        | 194,101        | 200,926        | 207,520        | 216,469        |
| Pronarë të vetëm                               | 2,108          | 1,790          | 2,098          | 1,385          | 1,202          |
| <b>Totali</b>                                  | <b>200,584</b> | <b>195,891</b> | <b>208,905</b> | <b>208,905</b> | <b>217,671</b> |

Burimi : Puna e vetë autorit bazuar në të dhënat e BPRM

Në Republikën e Maqedonise së Veriut institucionet financiare (bankat dhe kursimoret) veprojnë sipas rregullores dhe udhëzimeve të Bankes Popullore të Maqedonisë së Veriut. Kështuqë te sistemi i analizës së mikrokreditimit të të gjitha institucionet financiare ka disa shtylla të përbashkëta të cilës i përmbahen të gjitha institucionet:

- **Udhëzimi për implementimin e vendimit për limitin e ekspozimit kreditor për subjekte;**
- **Vendimi për metodologjinë e menaxhimit të riskut kreditor**
- **Vendimi për menyren e identifikimit të subjekteve të nderlidhura;**
- **Vendimi për permbajtjen dhe formën e funksionimit të regjistrit kreditorë.**

Të gjitha këto koncepte të lartpërmendura në këto tre vitet e fundit kanë hasur në ndryshime me qëllim që sistemi bankar në vend të jetë sa më efikas dhe si rrjedhojë edhe sistemi i analizës së mikrokredive të bëjë vendimet më efikase dhe eficiente.

Derisa në vitet e fundit kemi një digjitalizim të procesit të punës edhe në institucionet financiare në Republikën e Maqedonise së Veriut ku si qëllim kryesor është që të rritet efikasiteti dhe efienca e këtyre institucioneve.

Duke pas parasysh se të hyrat e institucioneve financiare kryesisht gjenerohen nga interesi i kredive dhe provizioneve të ndryshme nga klientet e tyre është më se e rëndësishme për bankat dhe kursimoret që të ofrojnë shërbime sa më efikase dhe eficiente në treg.

Si rezultat i konkurrencës së madhe në një treg të kufizuar si Republika e Maqedonisë së Veriut të gjitha institucionet financiare mundohen që të thjeshtesojnë byrokracinë në procesin e punës. E si pjesë e kësaj fokus i veçantë i kushtohet minimizimit të byrokracisë në sistemin e mikrokredivë.

Nga hulumtimi jonë kemi evidentuar disa procese të punës nga institucionet financiare në Republikën e Maqedonisë së Veriut që kanë për qëllim thjeshtësimin e byrokracisë në sistemin e analizës së mikrokredivë:

- Miratime masovike të kredivë për subjekte të caktuara

Institucionet financiare më të mëdha në vend : Stopanska Banka A.D. Shkup, Komercijalna Banka A.D. Shkup , NLB Banka A.D. Shkup , Halk Banka A.D. Shkup dhe Ohridska Banka A.D. Shkup bëjnë klasifikim të klientëve në baze të bilanseve përfundimtare të vitit të fundit. Bilanset merren si të gatshme nga Drejtoria e të hyrave publike të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe me një sistem eliminator të klasifikimit të subjekteve (rezultati financiarë i vitit të fundit, të hyrat, obligimet e ndermarrjes, kapitali etj) arrijnë që të bëjnë klasifikim të ndermarrjeve dhe duke u bazuar në të njëjtin klasifikim pregadisnin oferta për kredi të cilat i dorëzojnë deri te ndermarrjet.

- Aplikime direkte nëpërmjet faqeve të internetit të institucioneve financiare .

Bankat dhe kursimoret në vitet e fundit për klientet e tyre ofrojnë shërbimin e aplikimit për mikrokredi në faqet e tyre të internetit. Në formën e aplikimit nga ana e subjektit përkatës kërkohen të dhënat baze si emri, aktiviteti, vendndodhja, dokumente financiare etj.

Vet procesi i aplikimit u mundëson institucioneve financiare që të shpejtojnë sistemin e analizës së kredivë në atë formë që të dhënat merren drejtperdrejt nga klientët në kohë reale.

- Miratimi dhe dhënia “online” e garancioneve për ndermarrjet .

Si produkt i kërkuar nga mikrondërmarrjet në vend shpesh paraqiten edhe garancionet bankare si produkte kreditore. Prosesi për të siguruar një garancion bankar është thjeshtesuar deri në atë nivel sa që i gjithë procesi zhvillohet “online” deri në leshimin e garancionit dhe nënshkrimin e kontratave të garancionit. Pra aplikimi bëhet

online, sigurimi i dokumentacionit të nevojshem nga mikroklientet realizohet gjithashtuë në forme digjitale dhe në fund të procesit në rast se kërkesa miratohet kontaktohet klienti që të nënshkruaj me nënshkrim digjital ose fizikisht në filijalen e institucionit përkatës me çka procesi mbyllet me marrjen e garancionit nga mikro-klienti.

Të gjitha këto procese të lartpërmendura duke marrë parasysh të dhënat zyrtare që i kemi analizuar në tabelat e mësipërme, nga institucione të ndryshme në RMV, kanë bërë që në Republikën e Maqedonise se Veriut thjeshtesimi i byrokracise ne sistemin e mikrokredive ti bëje vendimet me efikase dhe eficente me çka qëllimi kryesor është rritja e produktivitetit si për mikro-klientët ashtu edhe për institucionet financiare në vend.

**Hipoteza kryesore (H2)** :Analiza e bazuar edhe në informacionet faktike dhe joformale redukton kreditë e këqija

**Hipoteza ndihmëse (H2.1)** :Informacionet asimetrike ndihmojnë vërtetsinë e bonitetit dhe reduktojnë kreditë e këqija

Për të shqyrtuar këto dy hipoteza dhe për të arritur në një konkludim në lidhje me të njejtat kemi perdorur të dhënat e fundit për kredite e keqija nga Banka Popullore e Maqedonise se Veriut për pesë vitet e fundit dhe dy pyetesore të plotesuar nga më shumë se pesë institucione financiare në vend.

Sipas të dhënave nga Banka Popullore e Maqedonise se Veriut raporti në mes të kredive të keqija dhe totalit të kredive të miratuara për subjektet juridike-jo-financiare është përshkruar në tabelën 12 :

**Tabela 11** : Raporti mes kredive të këqija/totali i kredive (subjekte juridike jo-financiare)

| Data e raportit                           | 31.12.2015 | 31.12.2016 | 31.12.2017 | 31.12.2018 | 31.12.2019 |
|---|------------|------------|------------|------------|------------|
| Raporti kredite e keqija/totali i kredive | 10.8 %     | 6.6%       | 6.3%       | 5.2%       | 4.8%       |

Burimi : Puna e vetë autorit bazuar në të dhënat e BPRM

Nga tabela e mësipërme mund të shohim që institucionet financiare në vend hasin në një trend të uljes së raportit të kredive të këqija/totalit të kredive.

Mirëpo që të arrijmë të vërtetimi ose jo i hipotezave të lartpërmendura kemi përdorur pyetësorë anketues të drejtuar 110 bankierëve të punësuar në dhjetë institucioneve financiare të ndryshme në vend .

**Tabela 12** : Pozita e të anketuarve

| Pozita e të anketuarve                     | Numri i të anketuarve | %    |
|--|-----------------------|------|
| Referent                                   | 60                    | 54.6 |
| Analist kreditor                           | 40                    | 36.3 |
| Udheheqës në sektorin e analizës kreditore | 10                    | 9.1  |
| Total                                      | 110                   | 100  |

Burimi : Puna e vetë autorit bazuar në të dhënat e të anketuarve

- **1 Referent**
- **2 Analiste kreditor**
- **3 Pozita udheheqëse në sektorin e analizës kreditore**

Për ta realizuar këtë pyetësor u anketuan 110 bankierë në pozita të ndryshme dhe të punësuar nëpër banka të ndryshme në Republikën e Maqedonisë së Veriut në periudhën kohore prej 01.02.2020 deri më 20.02.2020 . Qëllimi i përzgjedhjes së këtyre pozitave nëpër institucione

financiare ishte që të mund të nxjerrim një konkluzion sa më të sakte rreth hipotezave që po i shqyrtojmë në këtë punim : H1- *Analiza e bazuar edhe në informacionet faktike dhe joformale redukton kreditë e këqia* dhe H2.1- *Informacionet asimetrike ndihmojnë vërtetsinë e bonitetit dhe reduktojnë kreditë e këqia*.

Procesi i anketimit u realizua në atë formë që të gjithë të anketuarëve u është dërguar një pyetesor me dhjetë pyetje prej të cilave tetë pyetje janë me përgjigje *po* ose *jo* ose *pjesërisht* dhe dy pyetje janë me përgjigje *po* ose *jo*. Pyetesori u strukturua në atë formë që të mund të plotesohet për një kohë të shkurtër dhe me përgjigje precize.

Nga informatat kthyesë që më së shumti nëpërmjet këtij pyetesori arritëm në këto konkluzione:

- Vizita e ndermarrjeve mikro në terren e patjetersueshme

Edhe pse të gjitha institucionet financiare në vend gjatë procesit të mikrokreditimit u përmbahen standardeve të paracaktuara nga Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut duke marrë parasysh gjendjen faktike të ekonomisë jo-formale në vend, këto institucione praktikojnë pa përjashtim vizitat e klienteve që aplikojnë për mikrokredi me qëllim të krijimit të një pasqyre sa më të sakte të gjendjes financiare dhe ekonomike të sipërmarrjeve.

Pyetjes së 4 e praktikoni viziten në terren të klientëve të mikro ndermarrjeve nga të anketuarit më së shumti informata kthyesë që në realitet të gjitha institucionet financiare në vend e praktikojnë viziten në terren dhe në këtë proces janë kryesisht të angazhuar referentët me disa përjashtime ku edhe udhëheqësit e sektorit të analizës kreditore e praktikojnë një proces të tillë. Nga referentët e intervistuar 91.6% u përgjigjen me *po*, 55 nga 60 të intervistuarit. Derisa vetëm 8.4% apo 5 të intervistuar u përgjigjen se *jo* nuk e praktikojnë një gjë të tillë. Ndërsa udhëheqësit e sektorit të analizës kreditore nga anketimi : 2 prej 10 të anketuarve u përgjigjen se në rast të caktuara e praktikojnë viziten në terren apo 20%. Ndërsa 8 të tjerë u përgjigjen se nuk e praktikojnë viziten apo 80%. Për shkak të natyrës së pozitës së punës analistët kreditore nuk praktikojnë vizitën në terren.

**Tabela 13** : A praktikoni viziten në terren të mikro bizneset?

| Pozita e punës                             | Po | Jo | Përqindja |     |
|--|----|----|-----------|-----|
| Referent                                   | 55 | 5  | 91.6      | 8.4 |
| Udhëheqës në sektorin e analizës kreditore | 2  | 8  | 20        | 80  |

Burimi : Puna e vetë autorit bazuar në të dhënat e të anketuarve .

- Bazuar ne rezultaet e pyetesorit tone ku anketuam te punesuarit ne institucione te ndryshme financiare arritem qe te vertetojme hipotezen H2 :

H2: Analiza e bazuar edhe në informacionet faktike dhe joformale redukton kreditë e këqija

Institucionet financiare në vend duke marre parasysh gjendjen faktike të funksionimit të mikrobizneseve ku ekonomija jo-formale është tejmase prezente ,e kanë të patjetersueshme që analizën kreditore përvec standardeve të paracaktuara nga Banka Popullore e Republikës se Maqedonise së Veriut ta mbeshtesin edhe në informacionet faktike dhe joformale me qëllim të reduktimit të kredive te keqija. Sikur në shembullin e mesiperme me anketimin ku të punesuarit nëper banka të ndryshme në vend u përgjijgen bindshem se aplikojnë viziten në terren tek mikro-bizneset me qellim të krijimit të pasqyres sa me të sakt financiare dhe ekonomike të mikrobizneseve gjithashtu edhe pergjijget e tjera në anketimi na bindin qe të vërtetojmë këtë hipoteze.

Nga institucionet financiare në vend pikërisht informacionet asimetrike paraqesin njërin ndër rreziqet me të shpeshta që paraqiten në procesin e miratimit të mikrokredive. Edhe pas metodave të lartpermendura që vertetuan hipotezen e pare sikur informacionet faktike dhe joformale reduktojnë kredite e keqija prapseprap kredidhënesit janë të ekspozuar rreziqeve nga informacionet asimetrike. Për shkak të funksionimit jo-formal të biznesit në vendin tonë krijohen hapësira për gabime gjatë analizës kreditore.

Si rreziqe kryesore në procesin e analizës kreditore të mikrokredive është pikërisht informacioni asimetrik. Mund të paraqitet në formen e pronësise së biznesit në raste kur pronari formal nuk korrespondon me pronarin real,stoqet fiktive,shfrytezimi i mjeteve për qellime të ndryshme nga ato të paraqitura ndaj institucioneve financiare . Të gjitha këto rreziqe edhe pas aplikimit të masave të ndryshme nga ana e institucioneve financiare nuk mund që tëresisht të evitohen.Fakti që institucionet financiare në vitet e fundit insistojnë në kreditimin e atyre mikrobizneseve ku maksimalisht është i formalizuar procesi i punës është tregues kyc që informacionet asimetrike paraqesin rrezik në vërtetesine e bonitetit dhe paraqesin potencial në rritjen e kredive të keqija.

## 5.4 Rezultatet nga anketimi

Anketa janë ndarë në dy pjesë ku kemi anketa e klientëve dhe analistëve kreditor përfshinë 11 pyetje nga anketa e pare dhe 14 pyetje anketa e dytë, nga të cilët janë marrë

mendimet dhe qëndrimet .Për të ilustruar sfondin e të anketuarve dhe kush janë ata në të vërtetë, ne mblodhëm disa informata në lidhje me moshën, gjininë, qytetin dhe periudhën e të qenit klient në disa prej pesë bankave që ne vendim tone cilesohet si banka të mëdha dhe me një numer të madhë të klientellës .

Pyetësorët nuk janë të personalizuar sepse të gjithë të anketuarit mbahen anonim. Prandaj, ne nuk kemi informacion të thelluar rreth tyre.Pyetjet janë realizuar në këto mënyra : ballë për ballë, përmes telefonit dhe në internet. Me qëllim të rritjes së numrit të pjesëmarrësve në pyetësor, e shfrytezova mundësin si puntore ne njëren prej ketyre bankave dhe me ndihmen e kolegeve në bankat tjera që të anketojmë disa klient , duke përfshirë feedbackun e klientëve konsiderohet të jetë mënyra më e mirë e duhur për të zbuluar nivelin e shërbimeve kreditore informacionet a jane të mjaftueshme që të cojnë drejt vendimeve efikase dhe eficiente të vendosjes së kredive , në këtë mënyre do të shohim a janë të informuar klientët .

Për të vërtetuar hipotezat e parapara në hulumtim, fillimisht do të bëjmë interpretimin e rezultateve të realizuara nga pyetësori në formë statistikore sipas rradhitjes së pyetjeve të parapara në pyetësor.

Të dhënat e përpunuara nga përgjigjet e siguruara prej personave ( fizik dhe juridik) dhe punojnësit bankar do t'i paraqesim me anë të tabelave të paraqitura në programin Microsoft Word, dhe grafikonet e përpiluara në programin Microsoft Excel, me qëllim të vetëm, që t'i bëjmë sa më të qarta përgjigjet e të anketuarve.

Shpërndarja gjinore e të anketuarve përbëhej nga 47 pjesëmarrës meshkuj ose 47% meshkuj dhe 18 femra nga 65 totali. Statistikat përshkruese gjinore të Pyetësorit paraqiten në Tabelën 15 .



### Gjinia

|          | Frekuencë | Përqindje |
|----------|-----------|-----------|
| Mashkull | 47        | 72%       |
| Femer    | 18        | 28%       |
| Totali   | 65        | 100%      |

*Tabela 16: Statistika Gjinore nga pyetësi Sistemi i Analizës të miratimit të Kredive*

Në pyetësin nga qytetet ; 50 pjesëmarrës ose 50% janë nga Tetova , 10 pjesëmarrës ose 10% nga Shkup , 5 pjesëmarrës ose 5% nga Gostivari . Tabela 16 .

### Qyteti

|          | Frekuencë | Përqindja |
|----------|-----------|-----------|
| Tetov    | 50        | 77%       |
| Shkup    | 10        | 15%       |
| Gostivar | 5         | 8%        |
| Totali   | 65        | 100%      |

*Tabela 16 : Statistika e qyteteve nga pyetësi Sistemi i Analizës të miratimit të Kredive*

Pjesëmarrësit e pyetësit ishin nga grupmosha të ndryshme, të tilla si vetëm asnjë pjesëmarrës nga mosha ndër 20 vjet , 5 prej tyre ose 5 në mes 20 dhe 29 vjet , ndersa 34 prej tyre i takojnë moshës nga 30 deri 39 vjet , 15 prej tyre i takojnë moshës 40-49 , 11 prej tyre i ose 11% janë mbi moshën 49 vjet .

### Vitet

|       | Frekuencë | Përqindja |
|-------|-----------|-----------|
| <20   | 0         | 0%        |
| 20-29 | 5         | 8%        |

|        |    |      |
|--------|----|------|
| 30-39  | 34 | 52%  |
| 40-49  | 15 | 23%  |
| <49    | 11 | 17%  |
| Totali | 65 | 100% |

*Tabela 17 : Statistika e viteve nga pyetësi Sistemi i Analizës të miratimit të Kredive*

Statistikat pëshkruese nga pyetja se sa kohë keni që jeni klientë në njërin nga bankat :

- ❖ 2 pjesëmarrës ose 2% u përgjigjën se "sapo kanë filluar tani "
- ❖ 4 pjesëmarrës ose 4% u përgjigjën " klient më pak se gjashtë muaj "
- ❖ 6 pjesëmarrës ose 6% u përgjigjën " klient gjashtë muaj më pak se një vitë "
- ❖ 15 pjesëmarrës ose 15 % u përgjigjën " klient 1-2 vite "
- ❖ 38 pjesëmarrës ose 38% u përgjigjën " klient 3 dhe më shumë "

#### **Periudha e të qenit klientë**

|                             | Frekuencë | Përqindja |
|-----------------------------|-----------|-----------|
| Sapo kanë filluar           | 2         | 3%        |
| Më pak se gjashtë muaj      | 4         | 6%        |
| Gjashtë muaj deri në 1 vitë | 6         | 9%        |
| 1-2 vjet                    | 15        | 23%       |
| 3 dhe më shumë              | 38        | 59%       |
| Totali                      | 65        | 100%      |

*Tabela 18 : Statistikat përshkruese të periudhës qenit klientë në bankë nga pyetësi Sistemi i Analizës të miratimit të Kredive*

Kur pyesim se në cilën bankë keni llogari përgjigjen e kemi në Tabelen 1.5 që shohim se 19 janë përgjigjur në Stopanaska Banka , 18 klientë nga NLB Tuntunaska Banka , 14 janë përgjigjur në Ohridska Banka , 12 klientë janë përgjigjur me Halk Bankën dhe 2 janë përgjigjur me Komercijalna . Klientët janë zgjedhur me qëllim nga bankat më të mëdha shohim se numrin më të madhë të pjestarëve e ka Stopanska Banka .

### Llogaria bankare

|                | Frekuencë | Përqindja |
|----------------|-----------|-----------|
| Stopanksa      | 19        | 29%       |
| NLB Tutunksa   | 18        | 28%       |
| Ohridska Banka | 14        | 22%       |
| HalkBanka      | 12        | 18%       |
| Komercijalna   | 2         | 3%        |
| Totali         | 65        | 100%      |

*Tabela 19 : Statistikat përshkruese të llogarive bankare në disa banka nga pyetësi  
Sistemi i Analizës të miratimit të Kredive*


Pjesëmarësit në anketë janë më së shumti persona aktiv me biznese dhe pyetja e rradhës është koha se prej kur janë aktiv me biznesin e tyre nga pjesëmarrësit kemi po keta përgjigje nga 0-2 vjetë kemi 3 pjesmarës , 2-5 vjetë janë përgjigjur 11 pjesmarës , 5-10 vjetë janë përgjigjur 13 pjesmarës dhe mbi 10 vjetë kemi 38 pjesmarës . Nga këta numra shohim se kemi një numër më të madhë të klientëve i kemi hasur me traditë biznesore nga pjesmarësi mbi 10 vjetë aktiv .

### Koha aktive me biznes

|              | Frekuencë | Përqindja |
|--------------|-----------|-----------|
| 0-2 vjetë    | 3         | 5%        |
| 2- 5 vjetë   | 11        | 17%       |
| 5-10 vjetë   | 13        | 20%       |
| Mbi 10 vjetë | 38        | 58%       |
| Totali       | 65        | 100%      |

*Tabela 20 : Statistikat përshkruese se klientës sa kohë kanë që janë aktiv me biznes nga pyetësi  
Sistemi i Analizës të miratimit të Kredive*


Pyeta e shtatë është Sa jeni të kënaqur nga institucionet bankare dhe nga shërbimi i tyre ? Nga të anketuarit kemi arritur të fitojmë po këta numra ku 13% e të anketuarve nuk janë të kënaqur me shërbimet bankare 60% janë të kënaqur nga shërbimet që ofron banka dhe 27% janë shumë të kënaqur nga shërbimi dhe institucionet , sidoqoftë ato do të duhet të vazhdojnë ta përmirësojnë shërbimet e tyre nga kjo rrjedh që bankat duhet të fokusohen më shumë te klienti që numri i pakënaqesive të jete sa me i vogel .Edhe pse mund të konkludojmë që numrat momental tregojnë se bankat punojnë shumë në këtë aspekt .



*Figura 6 : Statistikat përshkruese sa janë të kënaqur nga institucionet bankare dhe nga shërbimi i tyre nga pyetësi Sistemi i Analizës të miratimit të Kredive*


Në Figurën në vijim kemi pyetjen : **Se si e shfrytëzojnë kreditet dhe produktet tjera kreditore për nevoja personale apo biznesore ?**

Përgjigjet e fituara nga pjesmarësit kemi me nevoja personale 8% të anketuarëve dhe për nevoja biznesore kemi 92% të pjesmarësve .



*Figura 7 : Statistikat se si i shfytëzojnë produktet kreditore nga shërbimi i tyre nga pyetësi Sistemi i Analizës të miratimit të Kredive*

Tek Figura 1.3 ne vijim është pyetur se cilët produkte dhe shërbime përdorin aktualisht ? Nga 65 klientë kemi arritur në këto përqindje ku vërejm se kemi zgjedhur 92% te klienteve mikro biznesor ndërsa 8% shfytëzojnë produktet si persona fizik .




*Figura 8 : Statistikat Produktet bankare nga pyetësi Sistemi i Analizës të miratimit të Kredive*

Nga klientët aktual vërejm që kemi 50% tek klientëve që e shfrytojnë kredin biznesore mikro ne 50% qëllimi ynë është që të arim deri tek hipotezat kemi anketuar klientë biznesor dhe i kemi pyetur produktet që ato më së shumti kanë nevojë kjo përqindje na tregon se mikro firmat mbijetojnë me kredit nga bankat nga të anketuarit të gjithë shfrytojnë kartelat debitore / ATM trendi më i ri i banakave është të shfrytohet sa më shumë qasja online vërejm 75% që ky numër shkon në rritje kërkohet që të jenë më fleksibil dhe efektiv të kryen pagesa online dhe të largohen nga pritja e gjatë para sporteleve . Depzot 25% , Kredi për ndërtim 5% dhe si persona fizik ne 15% .

Bizneset mikro në të shumtën e rasteve nuk shikojnë normën kamatore edhe pse ato gjithmon janë jo të kënaqur , por nevojat bazike te biznesit e bëjnë të patjetrsushme te kërkojnë ndihmë nga bankat në Figurën 1.4 shohim se 42% (28 Biznese) janë përgjigjur me Po pyetjes se banka me të cilën punojnë ofron normë konkurente te interesit ndërsa 58%(37 Biznese ) me Jo .

Cilësia e informacionit në lidhje me kredinë siguruar nga punojnësit ?

- Të kënaqur nga informacionet
- Mundet edhe ma qartë
- Menaxhimi i dobët i informacionit dhe jo të kuptueshëm
- Munges e informacioneve



*Figura 9 : Statistikat përshkruese e cilësisë së informacionit nga pyetësi Sistemi të Analizës së miratimit të kredive*

### **Anketë për punonjësit e bankës**

Për të arritur që të vlersojmë nivelin kreditor në bankat e RM kemi anketuar 50 punonjës që janë momentalisht duke punuar me kredi apo në të kaluarën kanë qenë në këtë pozicion . Nga këndvështrimi praktik dhe pjesa e përditshme e kesaj pune më ndihmuan deri te zgjedhja e strukturimit të pyetjeve që do na cojnë drejt dhënies së hipotezave . Pyetje janë realizuar nga punonjës të bankave të ndryshme puna tyre është e njejta nga struktura mirëpo çdo banke ka ndryshime në stilin , politiken e punës dhe sistemi tek disa banka nuk është i njejt . Mblodhëm

disa informacione se nga cila grupmoshë janë , niveli i shkollimit , sa kohë kanë që meren me kreditim , numri i analizave për periudhë një mujore pasi çdo punë që kryen e ke sfond vlerësimi nga udhëheqesit apo drejtorët e sektorit më fjalë tjeter vlerësohen në bazë të targetit , koha mesatare për punim të kërkeses dhe shumë pyetje tjera që do na ndohmojnë drejt përgjigjes së hipotezave . Pyetësi është realizuar nëpërmjet internetit dhe drejtpërdrejt me punojnësit .

Grupmosha e të anketuareve është nga 21-30 vjec kemi hasur 8 punojnës , 31-40 vjec janë 15 punojnës , 41-50 vjec ka 14 punojnës dhe prej 13 punojnëve nga 51-64 vjec . E verejm tek tabela 21

### Gjinia

| Mosha  | Frekuencë | Përqindja |
|--------|-----------|-----------|
| 21-30  | 8         | 16%       |
| 1-40   | 15        | 30%       |
| 41-50  | 14        | 28%       |
| 51-64  | 13        | 26%       |
| Totali | 50        | 100%      |

*Tabela 21 : Statistikat e grupmoshës nga pyetësi Sistemi i Analizës të miratimit të Kredive*

Nga niveli i shkollimit vërejmë se statistika e punojnësve janë 45 me studime deridiplomike dhe 5 punojnës me master nga nivelet tjera nuk kemi nga te anketuarit tanë .

### Niveli i shkollimit

| Niveli i shkollimit             | Frekuencë | Përqindja |
|---------------------------------|-----------|-----------|
| Shkollim i mesem                | 0         | 0%        |
| Studime deridiplomike           | 45        | 90%       |
| Studime pasdiplomike-<br>master | 5         | 10%       |
| Studime pasdiplomike-phd        | 0         | 0%        |



|        |    |      |
|--------|----|------|
| Totali | 50 | 100% |
|--------|----|------|

*Tabela 22 : Statistikat e nivelit të shkollimit nga pyetësi Sistemi i Analizës të miratimit të Kredive*

Koha që punojnë në bankë në sektorin e kreditimit e kemi ndarë në disa vite nga të cila kemi më pak se 3 vite që punojnë në kreditim janë 7 punojnës , nga 3 deri 6 vite kemi 24 punojnës , 6 deri 10 vite 11 punojnës dhe mbi 10 vite kemi hasur 8 punojnës që keta numra tregojnë se për të arritur në nivelin kreditor duhet të kalosh në disa faze tjera bankare siç është referent pagesash nga të anketuarit gati se 80% I kishin kaluar këtë rrugë përqindja më e madhe është vitit 3 deri 6 vite.

| Koha që merem me kreditim | Frekuencë | Përqindja |
|---------------------------|-----------|-----------|
| Deri në 3 vite            | 7         | 14%       |
| 3 deri 6                  | 24        | 48%       |
| 6 deri 10                 | 11        | 22%       |
| Mbi 10                    | 8         | 16%       |
| Totali                    | 50        | 100%      |

*Tabela 23 : Statistika se sa kohe meren me kreditim nga pyetësi Sistemi i Analizës të miratimit të Kredive*

Numri i analizave mbrenda një muaj është përgjigja e radhës për të vlersuar këtë performance ne vendosem krahasimin mes numrit të rasteve do anlizojmë disa pika që ndikojnë në kohën e pregaditjes së rastit edhe për matjen a analiza financiare, matja e pasqyrave te firmave , hierarkija bankare apo niveli i miratimit , kreditet e vogla apo mikro tek shumica e bankave miratohen nëper filjale që ndahen nga shuma e vlerës sa ma e vogel të jetë vlera aq shpejt kalon rasti pasi nuk kalon nëpër shum faza analisti i punon dhe miratohet nga drejtori apo përgjegjesi kreditor . Tek shumat më të mëdhaja kërkesa e dokumentacioneve , pasqyrat financiare , garancionet kerkojnë më shumë koha . Numri i analizave deri ne 3 gjatë

një mujorit janë pergjigjur 6 anlaistë , prej 3 deri në 6 raste ralizohen nga 13 analistë , 6 deri në 10 raste realizojnë 19 analistë dhe mbi 10 raste i kryejnë 12 analistë .

| Numri i analizave për 1 mujor | Frekuencë | Përqindja |
|-------------------------------|-----------|-----------|
| Deri 3 anliza                 | 6         | 12%       |
| Prej 3 deri 6                 | 13        | 26%       |
| Prej 6 deri 10                | 19        | 38%       |
| Mbi 10                        | 12        | 24%       |
| Totali                        | 50        | 100%      |

*Tabela 24 : Statistika i numrit të analizave për 1 mujor nga pyetësi Sistemi i Analizës të miratimit të Kredive*

Për të krijuar një pamje të plotë rreth procesit të vendimit të kredive anlistëve ju parashtruam pyetjen se sa është koha mesatare për përpunim të kërkesës së mikrokredive edhe këtu i ndajtm në sa ditë pune ju nevojiten për punimin e një analize nga 3 ditë pune kryejnë 24 analistë , 3 ditë deri 6 punojnë 20 analistë , 6 deri 10 ditë pune punojnë 4 analistë dhe mbi 10 ditë pune 2 analistë pas llogaritjes së rezultateteve numra tregojnë se analistët i punojnë ne kohe të shpejt analizat po ma shumë meret kontrolli nga pjesa tjeter udhëhqese që janë përgjegjes për miratimin e kredive .

| Koha mesatare e miratimit të kredis | Frekuencë | Përqindja |
|-------------------------------------|-----------|-----------|
| Deri në 3 ditë pune                 | 24        | 48%       |
| Prej 3 deri 6 ditë pune             | 20        | 40%       |
| Prej 6 deri 10 ditë pune            | 4         | 8%        |
| Mbi 10 ditë pune                    | 2         | 4%        |
| Totali                              | 50        | 100%      |

*Tabela 25 : Statistika e kohës mesatare i miratimit të kredive nga pyetësi Sistemi i Analizës të miratimit të Kredive*


Si do të ndikonin thjeshtësimet byrakuatike në kohën e analizës së mikrokredive këtë pyetje e kemi ndarë në Po ku shumica e analistëve kreditor janë të mendimit se do të kishte ndikuar

thjeshtësimet byrokratike 66% , ndërsa pjesërisht janë përgjigjur 28% te analistëve kreditor dhe me Jo 6% i analistëve .




Figura 10 : Thjeshtësimet byrokratike a do të kishin ndikuar në analizë nga pyetësi Sistemi i Analizës të miratimit të Kredive

Nga pyetja se a mundet thjeshtësimet byrokratike të ketë ndikim në kualitetin e analizës me përgjigje po jemi fituar 41% nga totali i 50 analistëve kreditor , me pjesërisht 44% dhe me Jo 15% i analistëve kreditor .



*Figura 11 : Thjeshtësimet byrokratike a do të kishin ndikuar në kualitetin e analizës nga pyetësi Sistemi i Analizës të miratimit të Kredive*

Vlerësimi i cilësisë së informacioneve nga regjistri kreditorë në RMV është pyetja e radhës e kemi ndar prej 0 deri 10 ku shohim se anlistët nuk janë të kënaqur nga cilësi dhe shpejtësia e regjistrimit nga 32 anlistë janë përgjigjur 0 deri 2 , 3 deri 6 kemi përgjigje nga 12 analistë kreditor me 7 deri 8 kemi 2 analistë dhe prej 9 deri 10 nuk kemi asnjë analistë këta numra tregojnë se regjistri kreditor nuk i nxjerr të dhënat mbrenda muajt po disa muaj më von dhe shumë ngadal kemi kthim të përgjigjes që mund të ndodh vonesë disa ditore .




*Figura 12 : Cilësia e informacioneve nga regjistri kreditor i RMV nga pyetësi Sistemi i Analizës të miratimit të Kredive*

Tek kapitulli i dytë kemi treguar rëndësin e e kësaj byroje për kredi që na ndihmonë në marrjen e informacioneve më të reja dhe në kohë të shpejt siguron tek bankat gjatë pregaditjes se analizës anilsti e ka të patjetersueshme . Si pyetje e radhës është si e vlerësojnë analistët cilësin e informacioneve nga byroja për kredi ku numri i madhë i analistëve 31 e vlersuan prej 9 deri 10 që kjo tregon se janë të kënaqur me shpejtësin dhe cilësin e kësaj byrooje , prej 7 deri 8

e vlerësuan 18 analistë , nga 3 deri 6 e kemi vec një analistë dhe prej 0 deri 2 nuk kemi asnje që është 0 .

Realizimi i detyrave të ndërmarrjes në masë të madhe varet nga informatat kontabiliste. Këto informata u ndihmojnë menaxherëve në situatat dhe problemet më të ndryshme, të marrin vendime afariste racionale për zgjidhjen e suksesshme të problemeve dhe për arritjen e fitimit më të madh(Nada Jovanova – SHMK “Jovçe Tesliçkov” – Veles). Në vendet e vogla mikro bizneset më shumë funksionojnë në mënyre jo formale që kjo na shpije drejt mungesese së informatave kontabiliste dhe e bën më të vështirë dhënien e kredive për këta subjekte nga pyetja e radhës ndikimi i kontabilitetit të subjekteve në efikasitetin e vendimarrjes për mikrokreditet analistët kreditor janë të mendimit se ndikon ku janë përgjigjur analistë me Po dhe 24 me Pjesërisht , gjatë pregaditjes së rasteve në mikro kredi mungesa kontable apo pasqyrat financiare nga puna jo formale e dergon firmën deri tek vështirësia për dhënie të kredive .




*Figura 13 : A ndikon kontabiliteti i subjekteve në efikasitetin e vendimarrjes për mikrokreditet nga pyetësi Sistemi i Analizës të miratimit të Kredive*

Tek pyetja e rradhës se si ndikojnë problemet me legalizimin e pronave në kadastër në vendimarrjen për mikrokredi 38 analistë janë të mendimit për Po se hasin pengesa për pregaditjen e rasteve në efikasitetin dhe eficiencën e vendimarrjes ndërsa 12 analistë janë për pjesërisht je 0 numri me Jo .




*Figura 14 : Ndikimi i problemeve me legalizimin e pronave në kadastër në vendimarrjen për mikrokredi nga pyetësi Sistemi i Analizës të miratimit të Kredive*

A ka ndryshime të mëdha në sistemin e analizës për mikrokredi në institucionin ku punoni tre vitet e fundit? I kemi ndarë në Jo që janë përgjigjur 24 analistë , me Po 12 analistë dhe tjetra a ka ndikime që ndikojnë dukshëm në procesin e analizës janë përgjigjur 14 analistë .



*Figura 15 : Ndryshimet në sistemin e analizës nga pyetësi Sistemi i Analizës të miratimit të Kredive*

Sa jeni të kënaqur me sistemin e analizës së mikroredive në institucionin financiar ku punoni?



*Figura 16 : Sa janë të kënaqur me sistemin e analizës nga pyetësi Sistemi i Analizës të miratimit të Kredive*

## 4.5 Testimi i hipotezave

| <i>Tabela XX: Testimi i hipotezave</i>  |  |
|---|--|
| <b>Hipoteza kryesore dhe ato ndihmëse</b>   | <b>Testimi i hipotezave</b><br>Për testimin e hipotezave jemi shërbyer me raportet e kreditimit dhe depozitave për pesë vitet e fundit nga Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut .Gjithashtu kemi marrë parasysh anketimin e punonjësve bankar.   |
| <b>1. Sistemi i analizës së mikrokreditimeve i bën vendimet më efikase dhe efçiente</b>       | Duke u bazuar në të dhënat e kredive dhe depozitave në RMV nga Banka Popullore, analiza një institucion financiar ( kursimore ) në kontekstin e mikrokredive, kemi sqaruar hapat që dergojnë deri te miratimit i kredive dhe proceset deri te shlyerja e kredisë , kemi anketuar klientë dhe punojnës bankar për të vlerësuar ritmin e kredidhënies ku erdhem në përfundim se rrjeti i kreditimit me kalimin e viteve ka pasur ndryshime në shpejtësinë e procesimit të kredidhënies ku niveli i ndryshimeve ka zvogluar kohën e një analize dhe ka rritur efikasitetin dhe efçiencen e procesit .<br>Pra, këto të fundit bëjnë që të kuptojmë se, ndryshimet pozitive në sistemin e analizës së mikrokreditimeve kanë pasur ndikim efikasitetin dhe efçiencën e vendimeve , andaj hipoteza kryesore: <b>1. Sistemi i analizës së mikrokreditimeve i bën vendimet më efikase dhe efçiente,</b> është e pranueshme. |
| <b>1.1 Thjeshtësimet byrokratike në këtë system mund të rritin efikasitetin dhe efciencën</b> | Përkrah institucioneve financiare që veprojnë në vend rol të rëndësishëm në këtë proces,pra në thjeshtësimet byrokratike në sistemin e mikrokreditimit kanë edhe institucionet e ndryshme shtetërore relevante në sistemin bankar të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Digjitalizimi i tyre si Drejtoria për të hyra publike ,Agjencia për   |



|  |   |
|--|---|
|  | <p>kadastër të patundshmërive,Regjistri qëndror i RMV-së , ndikon që edhe institucionet financiare të kenë qasje në kohë reale në të dhëna të ndryshme në kohë reale, që deri para disa viteve ishte e pamundur në RMV. Pra, duke u bazuar në trendin pozitiv të ndryshimeve në institucionet e lartpërmendura konstatojmë se hipoteza e parë ndihmëse: „<b>Thjeshtësimet byrokratike në këtë system mund të rritin efikasitetin dhe eficiencën</b>“ është e pranueshme.</p>  |
| <p><b>2. Informacionet faktike dhe joformale reduktojnë kreditë e këqija</b></p>                               | <p>Duke u bazuar nga anketimi të punësuarit nëpër banka te ndryshme në vend ku shumica u përgjigjen bindshëm se aplikojnë vizitën në terren te mikro-bizneset me qëllim të krijimit të pasqyrës sa më te sakt financiare dhe ekonomike te mikrobizneseve.Dhe indikacionet tjera nga anketimi na vërtetuan që në të vërtetë institucionet financiare në RMV i kushtojnë theks të veçant informacionit faktik dhe joformal duke pasur parasysh që mikrobiznesi në vend vepron në një ekonomi që ende nuk është tërësisht formale. Gjithashtu bazuar në të dhënat e BPRMV –së vërejmë që në tre vitet e fundit ka trend të zvogëlimit të numrit të kredive të këqija. Duke u bazuar në të dhënat e lartpërmendura që nga anketimi dhe deri te raportet zyrtare të BPRMV-së , konstatojmë se hipoteza e dytë kryesore „ <b>Informacionet faktike dhe joformale reduktojnë kreditë e këqija</b>“ është e pranueshme.</p> |
| <p><b>2.1 Informacionet asimetrike e ndihmojnë vërtetësinë e bonitetit dhe reduktojnë kreditë e këqija</b></p> | <p>Informacionet asimetrike paraqesin rreziqet më të shpeshta gjatë procesit të mikrokredive. Pikërisht nga funksionimi i biznesit joformal në vendin tonë krijohen rrethanat për gabime të shumta gjatë analizës kreditore dhe vendimmarrjes për kredidhënie. Dhe pikërisht informacionet asimetrike paraqesin rrezik potencial në vërtetësinë e bonitetit dhe paraqesin rrezik në rritjen e kredive të këqija. Duke u bazuar në rezultatet e hulumtimit</p>   |

tone nga anketimet dhe të dhënat nga institucionet e ndryshme shtetërore arrijmë në përfundimin që hipoteza e dytë ndihmëse ***“Informacionet asimetrike e ndihmojnë vërtetësinë e bonitetit dhe reduktojnë kreditë e këqija”*** nuk është e pranushme.

## KONKLuzionet dhe Rekomandimet

Objektivi kryesor i këtij studimi është të shqyrtohet boniteti dhe kredibiliteti i mikrokredivë ku theks të veçant i kemi dhënë analizës kreditore, se si ndikon efikasiteti dhe eficiency në miratimin e kredivë dhe analiza e kredivë të këqija në sistemin bankar në RMV .

Nga raportet e Bankës Popullore si dhe të agjensioneve të njohura të përcaktimit të rejtingut kreditorë si “S&P Global Ratings” kemi ardhur në përfundim se sistemi bankar në Republikën e Maqedonisë së Veriut është stabil dhe pikërisht analiza kreditore, përcaktimi i bonitetit dhe kredibilitetit të mikroredivë është faktorë i rëndësishëm në ruajtjen e këtij stabiliteti.

Në këtë punim shkencor ne kemi përfshirë të dhënat e kredivë dhe depozitave në RMV, kemi analizuar një institucion financiar ( kursimore ) në kontekstin e mikrokredivë, kemi sqaruar hapat që dërgojnë deri te miratimit i kredivë dhe proceset deri te shlyerja e kredisë, kemi anketuar klientë dhe punonjës bankar për të vlerësuar ritmin e kredidhënies ku erdhëm në përfundim se rrjeti i kreditimit me kalimin e viteve ka pasur ndryshime në shpejtësinë e procesimit të kredidhënies, ku niveli i ndryshimeve ka zvogëluar kohën e një analize dhe ka rritur efikasitetin dhe eficiency e procesit.

Bazuar në rezultatet e përfituara konkludojmë se në Republikën e Maqedonisë së Veriut është ruajtur stabiliteti i institucioneve financiare, rrjeti i kreditimit ka ambient të sigurt ku kreditë e këqija janë zvogëluar derisa kërkesa për kredi është në trend të rritjes. Organizimi dhe implementimi i procedurave tek sektori i kreditimit është në nivelin e duhur, nën mbikëqyrjen e Bankës Popullore të RMV-së.

Me qëllim që t’i shpalosim konkluzionet tona nga ky hulumtim shkencor, çdo hipotezë e kemi analizuar në veçanti :

**Hipoteza kryesore H1** - Në hipotezën e parë të parashtuar në këtë hulumtim : **“Sistemi i analizës së mikrokredivëve i bën vendimet më efikas dhe eficient”** arrijmë në konkluzionin që të pranohet hipoteza .Ndikimi i ndryshimeve në sistemin e analizës ,përgaditja e analizës, digjitalizimi i sistemit bankar në vend në keto tre vite të fundit kanë bërë që vendimet dhe procesi i kredidhënies të jetë sa më efikas dhe efficient .Në të njejtën kohë si shkak i konkurrencës së madhe në sistemin bankar në RMV institucionet financiare janë të

orientura në thjeshtësimin e procesit të kredidhënies në kuadër të procedurave dhe udhëzimeve të Bankës Popullore të RMV-së. Thjeshtësimi i sistemit të analizës së mikrokredive ka arritur në atë fazë që të bëjë të mundshëm miratimin e kredive mbrenda një dite ose mbrenda një jave. Që paraqet një ndryshim të dukshëm nëse e krahasojmë si proces para tre viteve ose më herët.

Kjo është vërtetuar në mënyrë të plotë duke u mbështetur në të dhënat e siguruara nga publikimet shtetërore dhe rezultatet nga anketa e realizuar.

**Hipoteza ndihmëse H1.1:** Si rezultat i konkurrencës së madhe në tregun e vendit tonë institucionet financiare mundohen të bëjnë thjeshtësime në procesin e punës. Në këtë punim shkencor kemi arritur të vërtetojmë hipotezën e dytë :” **Thjeshtësimet byrokratike në këtë system mund të rritin efikasitetin dhe eficiencën**”. Duhet theksuar që përkrah institucioneve financiare që veprojnë në vend rol të rëndësishëm në këtë proces, pra në thjeshtësimet byrokratike në sistemin e mikrokreditimit kanë edhe institucionet e ndryshme shtetërore relevante në sistemin bankar të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Digjitalizimi i tyre si Drejtoria për të hyra publike ,Agjencia për kadastër të patundshmërive, Regjistri qendror i RMV-së , ndikon që edhe institucionet financiare të kenë qasje në kohë reale në të dhëna të ndryshme në kohë reale, që deri para disa viteve ishte e pamundur në RMV. Të gjitha këto procese të ndërlidhura në bazë të anketimit tonë rezultojnë si faktorë kyç që vërtetojnë këtë hipotezë.

**Hipoteza kryesore H2:** Me qëllim që të arrijmë rezultat sa më të saktë për të testuar hipotezën e tretë: “**Informacionet faktike dhe joformale reduktojnë kreditë e këqija**” jami bazuar në të dhënat e Bankës Popullore të RMV-së dhe në anketimin e zyrtarëve të ndryshëm nga institucione të ndryshme financiare në vend. Në bazë të rezultatit që arritëm nga anketimi të punësuarit nëpër banka të ndryshme në vend u përgjijgen bindshëm se aplikojnë vizitën në terren të mikro-bizneset me qëllim të krijimit të pasqyrës sa më të saktë financiare dhe ekonomike të mikrobizneseve. Dhe indikacionet tjera nga anketimi na vërtetuan që në të vërtetë institucionet financiare në RMV i kushtojnë theks të veçant informacionit faktik dhe joformal duke pasur parasysh që mikrobiznesi në vend vepron në një ekonomi që ende nuk

është tërësisht formale. Gjithashtu nga të dhënat e BPRMV –së vërejmë që në tre vitet e fundit ka trend të zvogëlimit të numrit të kredive të këqija. Bazuar në rezultatet e hulumtimit mund të konstatojmë që informacionet faktike dhe joformale reduktojnë kreditë e këqija dhe hipoteza e tretë e këtij punimi shkencor pranohet .

**Hipoteza ndihmëse H2.1:** Duke u bazuar në rezultatet e hulumtimit tone nga anketimet dhe të dhënat nga institucionet e ndryshme shtetërore arrijmë në përfundimin që hipoteza e katërt : **“Informacionet asimetrike e ndihmojnë vërtetësinë e bonitetit dhe reduktojnë kreditë e këqija”** nuk qëndron dhe si e tillë nuk pranohet. Ekonomia joformale është prezente në RMV .Informacionet asimetrike paraqesin rreziqet më të shpeshta gjatë procesit të mikrokredive. Pikërisht nga funksionimi i biznesit joformal në vendin tonë krijohen rrethanat për gabime të shumta gjatë analizës kreditore dhe vendimmarrjes për kredidhënie. Dhe pikërisht informacionet asimetrike paraqesin rrezik potencial në vërtetësinë e bonitetit dhe paraqesin rrezik në rritjen e kredive të këqija.

Modeli kryesor i interpretimit të rezultateve është bërë nepërmjet qasjes krahasimore nga pyetësi dhe raportet e Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut për tre vitet e fundit.

#### **Rekomandimet që dalin nga ky studim janë:**

Nga ky hulumtim i analizës së bonitetit dhe kredibilitetit gjatë miratimit të mikrokredive dhe duke u bazuar në konkluzionet nga anketimet,të dhënat zyrtare të institucioneve të ndryshme në vend , kemi disa rekomandime në kontekstin e procesit të miratimit të mikrokredive dhe të analizës së bonitetit dhe kredibilitetit të mikrobizneseve:

- Janë të nevojshme investime në automatizimin e procesit të përcaktimit të bonitetit të mikrobizneseve .

Duke marrë parasysh nivelin e lartë të digjitalizimit të të dhënave nga shumë institucione shtetërore dhe private në vend si:Drejtoria për të hyra publike e RMV,Regjistri kreditorë i RMV e tjerë, rekomandojmë që nga institucionet financiare në RMV si bankat ashtu edhe kursimoret

me investime potenciale në zhvillimin e procesit të automatizimit të përcaktimit të bonitetit të mikrobizneseve duke u bazuar në të dhënat e gatshme nga Drejtoria e të hyrave publike dhe nga institucionet e tjera të lartpërmendura, do të shkurtonte kohën për përcaktimin e bonitetit dhe kredibilitetit të mikrobizneseve nga ana e institucionit financiar dukshëm dhe si rezultat i të njejtës do ta bënte procesin më efikas ;

- Angazhim më aktiv i institucioneve shtetërore në edukimin e mikrobizneseve

Në vitet e fundit shumë institucione financiare ndërkombëtare janë prezente në Republikën e Maqedonisë së Veriut nëpërmjet projekteve të ndryshme. Institucione si: EBRD(European Bank for Reconstruction and Development),EIB (European Investment Bank),ECB(European Central Bank) dhe institucione të tjera ofrojnë financim të projekteve të ndryshme në RMV me theks të veçantë në stimulimin e zhvillimit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme. Mirëpo si rezultat i mungesës së informacionit të duhur, mungesa e kuadrit përkatës dhe si rezultat i mosnjohjes së proceseve të prokurimit ndërkombëtar, shumë nga këto linja kreditore me kushte të volitshme ose grante të ndryshme mbeten të pashfrytëzuara nga mikrobizneset. Një angazhim më aktiv i institucioneve përkatëse në vend në edukimin e mikrobizneseve me anë të seminareve të ndryshme, kampanjave mediatike dhe formave tjera që i kanë në dispozicion do të kishte një dobi afatgjate si për mikrobizneset ashtu edhe për institucionet financiare të vendit dhe për ekonominë e vendit.

## LITERATURA E SHFRYTËZUAR

- <sup>1</sup> Colquitt J ,2007 :Credit Risk Menagment, faqe 1,2
- <sup>2</sup> Frederic Mishkin,2005” The Economics of Money, Banking, and Financial Markets, faqe 12
- <sup>3</sup> Frederic Mishkin,2005 :” The Economics of Money, Banking, and Financial Markets”,faqe 13
- <sup>4</sup> Barbara Casu,Claudia Girardone,Philip Molyneux,2015: Introduction to Banking, Barbara Casu,Claudia Girardone,Philip Molyneux,faqe 4
- <sup>5</sup> Gazmend Luboteni,2006:Bankat dhe afarizmi financiar – dr.Gazmend Luboteni,faqe 28
- <sup>6</sup><http://www.nbrm.mk>
- <sup>7</sup> <https://mba.mk/w/wp-content/uploads/2019/05/Presentation-Macedonian-Banking-Sector-Overview-May-2019>
- <sup>8</sup> <https://www.nbrm.mk/content/godisenbankarskisistem>
- <sup>9</sup>Raporti i stabilitetit financiar në Republikën e Maqedonisë në vitin 2017  
<https://www.stat.gov.mk>
- <sup>10</sup> Prof.dr. Sabahudin Komoni,2008:Financat ,faqe 194,195
- <sup>11</sup><http://www.stb.mk>
- <sup>12</sup> Violeta.M,2011:Politika kreditore,faqe 25,26
- <sup>13</sup><https://www.pcb.com.mk>
- <sup>14</sup>Goran Petrovski,2011 :”Upravuvanje so banki(vtoro izdanie),faqe 97
- <sup>15</sup><https://www.nbrm.mk/krediten-registar.nspix>
- <sup>16</sup><https://www.mkb.mk/mk/MKBPogled.aspx>
- <sup>17</sup>Goran Petrovski,2011:”Upravuvanje so banki(vtoro izdanie) ,faqe 97,98
- <sup>18</sup> Richard Apostoloski , Christopher Donohue , and Peter Went (2009) Foundation of banking risk Hobeken , New Jersey : John Wiles and Sons ,faqe 120
- <sup>19</sup>Violeta Macova,2016:”Kreditna politika”,faqe 46
- <sup>20</sup> Goran Petrovski ,2011:”Upravuvanje so banki(vtoro izdanie),faqe 99
- <sup>21</sup> Stepanova M , Lyn Thomas (2002 ) “Survival analysis methods for personal loan data “ ,faqe 1q

- <sup>22</sup> Peterlin.J,2004: “ Instrumenti za Uparuvanje Financijskim Rizicima “ faqe 13,21
- <sup>23</sup> Richard Apostolik , Christopher Donohue , and Peter Went (2009) , Foundations of Banking Risk. Hobeken , New Jersey : John Wiley and Sons ,faqe 120,121
- <sup>24</sup> Goran Petrovski ,2011:”Upravuvanje so banki(vtoro izdanie)” ,faqe 99
- <sup>25</sup> <https://www.nbrm.mk/izvestai>
- <sup>26</sup> <http://www.nbrm.mk/upravuvanjesokreditenzik>
- <sup>27</sup> Basel Committee on Banking Supervision,2006:”Credit risk management”.faqe 5,6 F
- <sup>28</sup> Colquitt,2007 :”Credit risk management”,faqe 287,291
- <sup>29</sup> [www.nbrm.com.mk/upravuvanjesokreditenzik](http://www.nbrm.com.mk/upravuvanjesokreditenzik)
- <sup>30</sup> “Sluzben vesnik na RM br.17/2008,Odluka za upravuvanje so kreditniot rizik”.faqe
- <sup>31</sup>: <http://nbrm.mk/ns-newsarticle-preddogovorni-informacii-kaj-potroshuvachkiot-kredit-pregled-na-ponudenite-kreditni-uslovi-al.nsp>
- <sup>32</sup> [www.stb.com.mk](http://www.stb.com.mk) , [www.nlb.mk](http://www.nlb.mk),
- <sup>33</sup> Analosa Laporan Keuangan Menggunakan ,2012: Analisis Horizontal – Vertikal Untuk Mengevaluasi faqe 188.
- <sup>34</sup> Altman, 2000:” Revulation and Altman’s Z-score , the Case od the Serbian Capital Market “ faqe 8
- <sup>35</sup> Jakubic. P ; Teply.P,2011:”The JT Index as an indicator of Financial Stability of Corporate Sektore “faqe 12
- <sup>36</sup> M.Dechow P,Yuan Sun E , Yu Wang A, 2013 : Australian journal of management 38 (3),faqe 5
- <sup>37</sup> <https://www.microworld.org/en/about-microworld/about-microcredit>
- <sup>38</sup> ECONOMICUS NR5/2010 Revistë Shkencore e Fakultetit Ekonomik Universiteti Europian i Tiranës (UET), faqe 133
- <sup>39</sup> Drake, Deborah ,2002:”The Commercialization of Microfinance. Kumarian” faqe 44
- <sup>40</sup> Bateman, Milford ,2010:” Why Doesn't Microfinance Work?”faqe 27,28
- <sup>41</sup> Spooner, Lysander 1846:” Poverty : Its illegal causes and legal care “ faqe 97
- <sup>42</sup> ECONOMICUS NR5/2010 . Revistë Shkencore e Fakultetit Ekonomik, Universiteti Europian i Tiranës (UET) . faqe 134,136



<sup>43</sup> <http://nbrm.mk/ns-newsarticle-sto-treba-da-znaete-za-kolateralot-pri-barane-kredit-od-banka-al.nspix>

<sup>44</sup> [www.moznosti.com.mk](http://www.moznosti.com.mk)



## SHTOJCA

Pyetsori

| Pozita  | Referent<br>(60 te anketuar) |    | Analist<br>kreditore<br>(40 te anketuar) |    | Udheheqes<br>ne sektorin e<br>analizes<br>kreditore<br>(10 te anketuar) |    |
|---|------------------------------|----|--|----|---|----|
|   | Po                           | Jo | Po                                       | Jo | Po  | Jo |
| <b>Pyetje</b>   | Pergjije                     |    |  |    |   |    |
| 1.Keni pervoje ne kete pozite mbi tre vite?   | 48                           | 12 | 35                                       | 5  | 9   | 1  |
| 2.A I merrni marasysh te dhenat jo-formale te klienteve gjate analizes kreditore              | 59                           | 1  | 34                                       | 6  | 7   | 3  |
| 3.Referencat nga gjendja ne terren meren parasysh ne analizen kreditore?                      | 23                           | 37 | 31                                       | 9  | 6   | 4  |
| 4.Regjistri qendror eshte indikator kryesor per analizen kreditore?                           | 41                           | 19 | 34                                       | 6  | 8   | 2  |
| 5.Byroja maqedonase e kreditimit eshte indikator kryesor per analizen kryesore?               | 14                           | 46 | 17                                       | 23 | 1   | 9  |
| 6.Historiati kreditor I pronarit nga raportet e mesiperme eshte faktor ne analizen kreditore? | 60                           | 0  | 38                                       | 2  | 10  | 0  |
| 7.Niveli i shkollimit te pronarit/drejtorit eshte faktore ne analizen kreditore?              | 17                           | 43 | 11                                       | 29 | 2   | 8  |
| 8.Mendoni se informacionet faktike dhe joformale do te ndikonin ne                            | 55                           | 5  | 39                                       | 1  | 10  | 0  |

|  |    |   |    |    |   |   |
|--|----|---|----|----|---|---|
| reduktimin e kredive te keqija?  |    |   |    |    |   |   |
| 9.A praktikoni viziten te klienti gjate analizes kreditore?                  | 55 | 5 | 0  | 40 | 2 | 8 |
| 10.Ekonomija joformale ne vend paraqet rrezik ne rritjen e kredive te keqija | 59 | 1 | 36 | 4  | 7 | 3 |

